

INTERVISTË ME LIRIJE PEPËN

Prishtinë | Data: 21 shtator, 2020

Kohëzgjatja: 115 minuta

Të pranishëm:

- Lirije Pepa (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Lirije, a mundeni me u prezantu, me na tregu datën e lindjes, vendin edhe diçka për familjen e juv të parë?

Lirije Pepa: Kam lindur në vitin 1945, në një familje mesatare. Po mendoj, kam pasun babën, nanën, gjyshën edhe një motër... një motër ma e para ajo ka vdekë, ka vdekë shumë herët që na s'e kemi njoft. Kështu që, po mendoj e kom pasë një fëmijë kështu të mirë, po mendoj sa mu më përket, se çdokush osht' pak a shumë... jo filozof, po mendoj mendimet i ka të ndryshme. Kështu që, babën e kom deshtë shumë, po ashtu edhe nanën. Nana ka qenë ma tepër e ngarkume normal me punë të shtëpisë, ndërsa baba është marrë me fotografi.

Kështu që, edhe ajo dëshira për fotografi më ka lindë qysh në momentin kur kom qenë shumë e vogël. Kur shkojsha në shkollë në vitin e parë mendojsha mësusin sikur me qenë nana, ashtu më dukej ai, ndoshta gjithkush e përjeton ndryshe. Po ndërkohë, mandej, shumë e vogël shkojsha ndonjëherë, se baba e ka pasë dyqanin... na kemi lind në Pejë, s'e ceka në fillim... dyqanin edhe shpesh shkojsha për bukë ose diçka a di, qysh më çojke nana.

Kështu që, mu më lindi dashuria për fotografi. Thojsha, "Merre me mend m'u bo farë fotografe e njoftun" po mendoj në atë kohë, ajo ka qenë vetëm, që thu, një dëshirë, s'di a realizohet a jo. Baba ka qenë shumë tip përparimtar kështu, ka pasë qef shkollimet normal secili m'i kry, tetëvjeçarën, shkollën fillore edhe tetëvjeçarën e kom kry në Pejë, gjimnazin po ashtu. Atëherë ka qenë gjimnazi "11 Maj", mandej "Bedri Pejani" tash osht'. Kështu që edhe në shkollën e mesme, në gjimnaz mirë e kom pasë, kom qenë...

Anita Susuri: Zonja Pepa, deshta m'u kthy edhe pak... në fillim e përmendët dyqanin e babës juv, në cilën lagje në Pejë e ka pasë, a ka qenë naj lagje ma e njoftun a?

Lirije Pepa: Ai si para neve, po ma vonë e ka ble në lagjen të Xhamia e Kuqe në Kapeshnicë, është një pjesë fillimi i Kapeshnicës. Ngucen pak, kjo ka metë prej turqishtës Kapeshnicë, demek përleshje ma tepër aty kanë qenë. Mirëpo, mu ato s'më kanë interesu, kanë qenë do familje të zgjedhuna në atë lagje, familja e Besim Sahatçisë, familja e shumë arqitektëve, si jonë këta, se i kom pasë edhe djemtë e

abës të gjithë aty. Ka qenë e përmbledhur një familje aty afër xhamisë, bukur familje e këtyne që thojnë pasunikëve. S'po mendoj pasuni pa asi... po, mesatarisht kanë qenë mirë. S'kanë pasë nevojë, po mendoj për ndihma të ndryshme në atë kohë.

Anita Susuri: Si ka qenë Peja në atë kohë, a ju kujtohet kur keni qenë ju fëmi?

Lirije Pepa: Peja për mu ka qenë shumë e bukur, po mendoj si fëmini, po mendoj... u çelë shkolla aty në Karagaç, është Karagaçi parku ku është. Krejt shkojshim shoqet e mahallës e të gjitha kemi qenë në një klasë. Mandej mësuesen, në fillim mësuesin, mandej bonë ndrrime a din, si në shkolla qysh ka qenë, po ka qenë shumë... s'po di shumë të knaqune edhe me lodra edhe me asi... për me mësu baba kontrollojke, se nana ka qenë shtëpiake, nuk ka qenë e shkollume, vetëm alfabetin që e kanë mësu në atë kohë, po mendoj.

E baba na i kontrollojke fletoret a i kemë bo detyrat, a jemi... shpesh une... kjo m'ka mbetë pi vogjlisë, ni fletore përpara i shkrujsha kënde, mrapa tjera, për me i qit në pastër {shpjegon me duar}, ai më kritikojke, a din, ka qenë shumë pedant. S'po thom une që s'kom qenë pedante, po s'kom pasë ndonji shkrim të bukur. E ma vonë e mersha këto se njerëzit inteligjent e kanë shkrimin e keq, a din kjo pak vetit me ja bo qefin.

Anita Susuri: Në cilën lagje ju...

Lirije Pepa: E kështu ka qenë po mendoj fëminia. Mandej në gjimnaz më regjistruan si zakonisht. Po atje shumicën e landëve i kemi pasë në gjuhën serbe. Kështu që, shpesh nuk e disha, për shembull matematikën, fizikën, ato terminat që jonë, a din për matematikë, shpesh u dufke me fjalor shqip ku kishte përkthime, gati 60 përqind sërbsisht i kemi pasë landët. Shqipja ka qenë normal në gjuhën shqipe, përveç gjuha frenge, se atëherë edhe frengjishten e kem mësu edhe landë tjera, po mendoj si gjithë gjimnazi klasik qysh ka qenë në atë kohë, veç edhe drejtori edhe të gjithë kanë qenë sërbe.

Anita Susuri: Ju jeni lindë në vitin '45, domethonë osht' pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore...

Lirije Pepa: Po.

Anita Susuri: A ju kujtohet ndoshta ndonji tregim i babës t'juj apo diçka, si ka qenë lufta, si e kanë përjetu?

Lirije Pepa: Më kujtohen disa gjana, nana, shpesh kur kalojke aeroplani {shikon lart} ajo, "Lirije..." se qëllojsha une gjithmonë, a din afër, "...hajde të shkojmë te halla", se e ka pasë njëfarë mbështetje te halla jeme për shkak ka qenë ma gru burrneshë, ma asi... E baba tregojke qysh i kanë virrë [varur] njerëzit, bile kena pasë fotografinë, po qysh u kall shtëpia gjatë, po mendoj kësaj luftës që ka qenë, jonë hup. Se kanë qenë njerëzit midis qendrës të Pejës të virrun {kap fytyrën}, ai i ka pasë fotografitë, po

ftografitë jonë zhdukë, a din zakonisht kur mbaron diçka edhe i len nëpër podrume. Kur u kall shpia jonë kallë edhe ato, shumicën s'kom mujt me i përmbledh edhe të fëminisë teme.

Kështu që, simbas nanës ajo u tmerru, thojke, “Shumë ka qenë fshtirë” edhe i ka pasë mbetë friga nga aeroplanet. Mirëpo, kanë banu edhe gjermanët edhe italianët, qysh kanë hi nëpër shtëpia në atë kohë. Tash çfarë lufte ka qenë ajo, nashta për atë kohë ka qenë mjaft asi... veç thojnë, “Neve s'na kanë nguc as gjermanët, as italianët”. Po mendoj përveç që bombardimi ka qenë i Pejës aty-këtu, qysh i përshkrun, tash s'po muj krejt, po mendoj... se disa gjana edhe i kom harru. Mirëpo, më kujtohen këto, sidomos aeroplani kur kalojke, nana gjithmonë për dorë, “Hajde të ikim!” Ka pasë nifare asi... Kjo ka qenë e tëra po menoj, për atë kohë.

Anita Susuri: E a e dini si ka fillu baba juj me u marrë me fotografim, pse pikërisht...

Lirije Pepa: Axha jem ka qenë fotografi i parë në Pejë edhe ka qenë qysh me thonë, barem qysh e përshkrujnë tepër i çeltë, sharmant, i bukur, po mendoj. E ato e mbysin, se ai ka qenë në njëfarë shoqate ilegale, kështu patriot ka qenë, a din. Ka qenë shok me këtë aktorin e njoftun këto Çarkagjiun, Masar Çarkagjiu...

Anita Susuri: E si është qujt axhi juaj?

Lirije Pepa: Riza Pepa. Kom edhe fotografi të tij. Ai ka qenë i pari edhe që ka qenë kështu si Don Zhuanat në atë kohë, jo me serbe, jo me ashtu, por patriot. Është marrë me njëfarë asi që vonë barem ka shkru në to, a din shoqata e disave, po mendoj të ri, si patrioti në atë kohë. Edhe këto po get... tash kush e ka mbyt na nuk e dimjë. Baba e gjon vorrin [e tij] në Kuqishtë, se ai ka shku shpesh a din, turista shpesh qysh kanë ardhë, Rugova ka qenë afër Pejës. E kështu që gjyshen shumë e kom deshtë edhe ajo gjithmonë kur palojke do tesha si me vajtu, a din. Thojsha, “Nonë...” thojsha, nonë e thirrshim, thotë, “Më ka...” a din, “djali”, po s'e dike ku, tek. Thojsha, “Kur te rritna kom me zbulu” a din, “vendin”, a din, si fantazi kjo.

Anita Susuri: Ai është vra para se me lind ju?

Lirije Pepa: {Afrohet për të dëgjuar}

Anita Susuri: A është vra para se me lind ju?

Lirije Pepa: Po, '44-shin, këto e mbaj në mend a din, se e kem pasë në Pejë ni krue në shpi ku vishin krejt mahalla me marrë ujë, edhe kanë qenë datat aty. Thojshin gjatë bombardimit ato... a e kanë mbytë, po mendoj të huajt, a e kanë mbytë edhe shiptarët, ndonji tradhtar, aty s'muj me ditë. Se baba i ka pasë shënu në ditar {bën sikur shkruan} datat e lindjës tonat... tada ka qenë baba, se unë e kom thirrë tadë. Edhe kur e ka gjetun vorrin, se në Kuqishtë të Rugovës ata...

Fotografët njihen prej thojve {prek majat e thonjëve} se kem punu shumë, unë vet për veti i kom pasë ngjyrë kafe, se bojsha toner për fotografi, edhe ajo merr ngjyrën. Kështu që, gjithkush që ka punu fotografi në laborator, se kamera e errët osht' edhe aty i punon fotografitë e po menoj me zhvillu, sfiksimi krejt i ki do elemente, po mendoj që muj m'i skjaru kështu po, po mendoj nashta s'jonë të randësishme.

Edhe prej thojve e ka ngjoftë që ka qenë axha. Na abej e kem thirrë po s'e kem ditë, veç qysh na kanë tregu se s'e kem njoft, veç me fotografi. Ai e ka pasë lonë ni djalë, ai ka vdekë. Nana jeme i ka dhonë gji, se ai ka qenë '43-shin, djali tij kur ka lindun, jo, po i bjen qashtu '43-shin edhe mandena nana e ka ushqy me gji për shkak se i vdes edhe gruja, axhës. Kështu që, i hupin, megjithëse djali vet ka fëmi këtu edhe në Prishtinë tash. Po mendoj djali i tij, po ata s'kanë trashëgu.

Familja jonë e ka trashëgu këto fotografinë, të gjithë gati, përveç motra e madhe. Se mbas vdekjes së babës unë kam punu me motrën e vogël, mandej fëmitë qysh jonë rritë simbas gjeneratës, se na kemi qenë ma të vjetra. Kështu që, jemi prej familjes gjashtë, asi, të gjithë jemi gjallë veç nana edhe baba që kanë vdekë. Baba më ka vdekë '70-tën, nana më ka vdekë u konë '99-shin, kur ka vdekë ky Jashari, Adem Jashari, në qat' kohë a din. U frigojke shumë prej luftës, po qe s'e di pse, ndoshta ajo osht' përsëritë, ajo. Kjo ka qenë e tëra, po mendoj sa i përket... kështu që ka qenë familje po mendoj e shnoh. Po mendoj ni fëmini e kem pasë, ushqim kem pasë, të gjitha kem pasë, s'kemi pasë nevojë për diçka. Kështu që...

Anita Susuri: Cili fëmi me radhë keni qenë ju?

Lirije Pepa: Urdhno?

Anita Susuri: Cili fëmi me radhë keni qenë ju? A keni qenë...

Lirije Pepa: Une e dyta, e treta në të vërtetë, ajo llogaritet që ka vdekë edhe mandej tjerët, ka dy vjet në mes me motra. Dy vjet jom ma e vogël se motra e madhe, dy vjet osht' ma e vogël motra mbas meje. Edhe mandej fillojnë djemtë, vllavi i madh, vllau i tjetër e ka dyqanin këtu në Prishtinë "Foto Pepa", ata në Pejë tjerët, po e kanë trashëgu tash fëmitë, se a din këta në pension, po menoj. E ky vllau tjetër tash del në pension edhe dy-tre, edhe dy muj qashtu diçka.

Anita Susuri: Si ka qenë me u rritë në një familje me aq fëmijë, me aq motra, vllazër?

Lirije Pepa: S'po di qysh me të thonë, ka qenë, po mendoj për të kalumen, baba ka qenë s'po mendoj ndonji pasanik i madh, mirëpo jetë normale. Ai gjithmonë i ka mledhë fëmitë e motrës, thuja se i ka rritë, për shkak se kanë qenë ma të vorfun. Ata të gjithë e kryjnë... është ky burri i Lule Pulës, ndoshta Lulën e dini? Po, Ekrem Beqiri, Qemajl Beqiri, ai arqitekt i parë ka qenë në Kosovë edhe Agush Beqiri,

baba i Florë Beqiri që e kanë atë kafiqin. S'ka lidhje, s'është me randësi, veç po du me thonë që kanë qenë të parët gati, të gjithë në Beograd kanë kry në atë kohë.

Kështu që, baba si fëmi i ka kqyrë tepër, për shkak se kushtet kanë qenë të tilla që... për shembull, halla ka qenë e martume për dikun që kanë qenë tepër të vorfun, si në atë kohë. S'mundna me përshkru se na s'e dimë qysh ka qenë, po mendoj për familjen teme që e kishim ushqimin si duhet, të gjitha i kishim. Atëherë ke qenë e lumtur kur i ki punët mirë, po mendoj shneta mirë na ka punu. Mandej, ma vonë kom pasë aty-këtu batica, zbatica, ndonji sëmundje a din, si zakonisht.

Anita Susuri: E ju si fëmi, qysh ju kujtohet herën e parë kur keni shku te baba në dyqan?

Lirije Pepa: Une kom shku shumë herë, mirëpo kur kom fillu veç me punu aty, kom qenë në moshën nontë vjeçare. Se më ka interesu fotografia edhe në fillim baba më jepte m'i la fotografitë, filmat, po me shumë kujdes për shkak se nëse filmin {përshkruan me duar} e grrith me durë, se a din duhshe me ato kimikalijat e ndryshme, ajo mbetet vizë ose ndonji shenjë, kështu që prishet fotoja. Po mendoj, del najfarë shenji që s'osht' e preferume shumë.

Kështu që, mandej vendosa kështu, edhe e mësova fotografimin. Ndërkohë vishin m'u fotografu, kërkush s'besojke, se edhe serbët a din, i qitsha [i fotofoja] pa pare veç mos me... se baba qëllojke, shkojke diku a din edhe qysh të lenë, se kanë qenë edhe mjeshtër tjerë, une kam qenë si shegër¹. Mirëpo, i fotofojsha thojsha, "Mos paguni kurgjo, kur të vini..." që me vërtetu që di me fotografu, për letërnjoftim kuptohet. Atëherë ka qenë fotografia ma... njerëzit shumë të interesum, tash i kemi këto që çdo kush gati fotografon edhe...

Fotografia është e çuditshme, jo që po foli për fotografi, po ti e bon fotografinë shumë të mirë, mirëpo nëse personi që o fotografu nuk i pëlqen a din qysh... une vet jom fotografe edhe kur s'më pëlqen thom, "Uhhhh! {onomatopeja} Këto s'pe qes ose këto p'e qes". Po mendoj kjo është, njeri duhet me qenë edhe psikolog ma tepër m'i përkushtu, jo veç pacientit po atë që e ki përballë sesa edhe fotografisë kështu mrapavisë e gjithave.

Anita Susuri: Për çka janë fotografu ma shumë njerëzit atëherë?

Lirije Pepa: Në atë kohë janë fotografu, kuptohet njëherë për letër të njoftimit, e mershim ni bez të zi {shpjegon me duar} për me dalë ftyra ma asi, ose të bardhë varet, mrapa dyqanit edhe i fotofojshim. Se mrenda e kem pasë ateljen që fotofojshim me plloqë, ke pasë me plloqë që delshin fotografi u retushoshin, si zbukurohen pak, a din me tush {tregon me gisht kah ftyra}. E ato kanë qenë ma të shtrejta edhe normal ma kualitet se, a din me reflektora, e ma ndryshe, e ke bo dritën qysh ki deshtë.

¹ Rrjedh nga fjala turke *sakirt* që do të thotë nxënës i zanatit.

Mandej, fotografitë në natyrë, kishin qejf. E sidomos, ka pasë ma tepër që kanë dalë të fshatrave sesa qytetarët. Kjo a din më ka ra... s'di pse që interesimi shumë ma i madh ka qenë i tyne edhe bash më çuditë se a din s'ka pasë fanatizëm ndoshta. E te qytetarët nëpër dasma, nëpër ndeja, a din kur kanë pasë, si zakonisht nëpër familje tona, ju jeni të reja ndoshta këto s'i dini, po farë zijafeti, farë diçka, a din, edhe normal që jonë tubu aty, fotografi.

Anita Susuri: A keni dalë edhe në terren, keni fotografu?

Lirije Pepa: Kem dalë në teren, po kjo ka qenë ma vonë hala pa më vdekë baba. Më thirrshin si femër nëpër fshatra për letrën e njoftimit. Kështu që, krejt atë pjesën e Deqanit, kom harru disa edhe këndeje ka Ujëmiri më bike me tren, shkojshim në mëngjes me vllaun. Ai ka qenë nontë vjeç, e unë 20 e, se dhjetë vjet osht' ma i ri se une, ai vllau që u marrë... Edhe aty shkojshim me fotografu për letër të njoftimit. Po a din qysh fshatrat, jo që i përshkruaj po në atë kohë ka pasë të pasun, ka qenë ni krye si me qenë kryetari...

Anita Susuri: Kryeplaku.

Lirije Pepa: Po. Kryeplaku. Edhe shpesh qëllojke ose Ramazan ose diçka edhe na metshim në rrugë tanë ditën, mersha fotoqafojsha. Po ka pasë raste, për shembull kur ni grus ja bona, "Krehi pak floktë" a din, {prekë floktët}. Edhe burri i vet veç e rrehi, a din qaq, pse vllavi mo ishte nontë vjeç, pse prezent vllau aty... Thashë, "M'fal për fotografi, fotografia duhet me qenë ma..." Edhe kështu që të gjitha kishin sukses. Boll me drojë fotoqafojsha, se s'din njeri, a duhesh me i përsërit prapë a din, po kanë pasë sukses kështu që...

Çak edhe televizorin e parë prej atyne që kem fitu, e kem pasë ble. Se në atë kohë kuptohet '70-tat, para '70-tave kjo ka qenë ngjarja, '78-tën andej-këndeje. Shumë kush s'ka pasë as televizor, s'kanë pasë, përveç radios, kështu ka qenë, ndoshta edhe ju keni gjysh që ju kanë tregu për ngjarjet. Po mandej baba kish qejf me studiu, psikologjinë kisha qejf po ajo në Zagreb, atëherë s'ka pasë këtu shansë. E pata regjistru gjuhën angleze, po jo me qejf se une gjuhën frenge, a din, e kom deshtë shumë. Kështu që, vitin e dytë e lëshova se prapë më lidhke fotografija.

Anita Susuri: E ju e keni kry tetëvjeçaren në Pejë a po?

Lirije Pepa: Në Pejë edhe gjimnazin.

Anita Susuri: Pastaj edhe gjimnazin.

Lirije Pepa: Po '64-tën, '65-tën.

Anita Susuri: A ka qenë atëherë e jashtëzakonshme që femrat me vazhdu shkollimin, a ka pasë shumë femra?

Lirije Pepa: Ka qenë, ka qenë edhe për fotografi për shembull se qysh femrat me punu, a din? Ka pasë baba paragjykim, jo baba po tjerët na paragjykojshin, a din, po mirë baba ka qenë shumë, në atë aspekt ka qenë shumë përparimtar. Ka qenë njeri pedant edhe ka pasë qef m'u vesh mirë edhe vet është vesh tepër mirë, nuk ka pasë ndonji bukuri baba, po baba si babë të duket gjithmonë i bukur. E axha ka qenë ma i bu... a di simbas fotografisë.

Kështu që, mos të flas për këto se s'janë qaq të randësishme. Po mandej '64-tën, '65-tën baba, "Regjistri diçka", thojsha, "Në Zagreb", në Zagreb dojshim me jetu na atje, po prapë ra puna baba u kthi këndej, se kish qef me shku. Po mendoj krejt familja m'u bajt se ka qenë situatë pak ma e ndryshme, jo koha e Rankoviçit, jo... Shumica '55-shin më kujtohet si fëmi, kur kanë shku në Turqi, atëhere vllau ky që është fotograf këtu ai ka pasë lind.

Na thojshim, "S'dojmë me shku" që thojshin visika, fisika s'di jonë konë do që i kanë pasë të nxirrne, si nifarë dokumenti që duhesh për me shku. Edhe ni kryehoxhë i mahallës, Mulla Isufi, ai shkon i pari në Turqi edhe e mbanë njëfarë mitingu, kem pasë fotografi po jonë djeg ato pamjet a din. Edhe më kujtohet si fëmi, s'jom konë bash e vogël, atëherë dhetë vjeçe gati, hiç pa gati. Thotë, "Une vllazër po shkoj" a din, "edhe ju mbas meje". Kjo ka qenë '55-tën kur me të madhe pejontë kanë shku në Turqi, kjo po mendoj më kujtohet kështu. Mandej, s'më kujtohet, e '64-tën...

Anita Susuri: E ju, baba juj s'ka dashtë me shku?

Lirije Pepa: Ja-a, ai ka qenë shumë në dilemë edhe gjeneratën e parë që shkojnë në Turqi, kanë shku si turistë se e ka pasë dajën e vet në Iskidar afër Stambollit, une kom shku ma vonë në Stamboll për me vizitu dajën jo, po familjarët që kanë mbetë. Kështu që, une kom mbri me shku në dasmën e djalit dajës, normal a din kështu, përhajr që po martohet, me dajën tem edhe mandej na u kthym. Vetëm që e kryva amanetin e hallës thojke, "Nëse shkon, po martohet" a din, thashë, "Po". E kështu që baba ka qenë edhe ata kanë qenë shumë të vorfun në Turqi, ky i ka mbajt me mish kur kanë shku. A din që shkojnë si turistë, mandej a din ju ka ndihmu materialisht, më kujtohet kur thojke a din, ka ndejt dhetë ditë a diçka veç me ju ndihmu. Se këtij kur i ka shku daja atje, baba ka qenë diku dhetë vjeç, këto janë krejt simbas tregimeve tyne, a din, po i kom regjistru.

Anita Susuri: E si ka qenë në shkollë, shkolla fillore, si ka qenë sistemi atëherë?

Lirije Pepa: {Afron kokën për të dëgjuar më mirë}

Anita Susuri: Kur ke shku ti në shkollë, kur keni shku ju në shkollë, si ka qenë sistemi atëherë?

Lirije Pepa: Sistemi me të tregu vetëm diçka që e lidhë edhe me të tashmen. Në klasën e parë fillore kisha Shemsi Gacaferrin mësues, po mendoj e mbaj mend mirë, ai ka vdekë tash shpejt. Ndërkohë ni kojshi ma mëson mu ni vjershë, “Besa-besën jam shiptarë” ndoshta asi... “se Shqipëria ma tha një fjalë më ke nënë, të kam djalë” e kom mbajtë përmendsh, a din kjo është ajo vjersha. Edhe une e recitoj, mësusi thotë, “Lirije shumë mirë” se thojke, “Kush din me recitu diçka?” Thojke, “Veç mos e recito diku”. Qet’ vjershë ia mësoj çikës vllaut, Mrikës, ajo e ka të kryme ekonominë, nejtë punon në Ministri të Integritimit. Edhe Mrikës, kur regjistrohet në klasën e parë këtu ia mësoj qet’ vjershë edhe e njejtë situatë përsëritet te ajo. Ja bon ni mësues aty qysh kenë, edhe psikologja e krejt, “Shumë qenke e zgjut po nuk o situata” a din, “për këtë vjershë”, qe qekjo ka qenë.

Anita Susuri: Atëherë para luftës ka qenë ndoshta?

Lirije Pepa: Kjo ka qenë pak para luftës, viti i parë që u regjistru mo në asi. Ka qenë pak situatë e keqe, me të vërtetë kështu e di që, bojshin dallime të mëdha. Se unë pata ardhë mandej në fakultet të mjeksisë me punu. ‘75-tën kom ardhë, mas vdekjes babës. Për shkak se u bomë shumë, edhe e pata mundësinë me u punësu aty, që thojsha t’ju liroj vend të rive, a din, familjarëve. Se une për shembull kisha pengu, me qenë e martume s’kom qenë a diçka që me thonë, as nuk jom martu (qesh). Tash jeta ku me ditë qysh të teket a din, edhe...

Anita Susuri: Deshta me ju kthy pak ma mrapa, para se me vazhdu te fakulteti, te puna juv. Deshta me pyt për shkollën e mesme, si ka qenë shoqëria atëherë a keni dalë dikun a, a keni pasë aktivitete jashtë, jashta shkollës domethënë?

Lirije Pepa: Në gjimnaz vitin e parë kemi qenë qysh bohen krejt të shkollave, tetëvjeçareve a din mledhen, mandej u bo ndrrimi. Une kom qenë në grupin shoqnor ke pasë edhe grupin shkencor. Ata që ju ka shku matematika e këto ma tepër, kanë shku në shkencor, ndërsa une kom mbetë vetun me 15 shokë. Po mendoj kom qenë e vetmja në klasë.

Anita Susuri: E vetmja femër.

Lirije Pepa: Përveç që ngel njona edhe me mu a din në bankë, po ma tepër kam qenë me shokë, për shkak se vet. Edhe i mbaj në mend krejt profesorat kush na jepshin. Po shumica kanë qenë në gjuhën serbe, për shembull matematika, latinishtja shqip, kesi latinisht po, sërbiht edhe a din përkthimin. Tana frengjishtja, shqip më ka pasë dhonë njëfarë Vera Rajoviq, ajo ka qenë e vjetër, sërbe po që ka kry edhe në Francë a din, ajo shumë më dojke, a din. Edhe shpesh më çojke te shpia vet kështu a din për me më provoku a e di gjuhën, kur shkojsha në klasë te sërbiht me lyp ni libër, ajo ma bojke, “Qysh duhet me thonë ndryshe?” a din, “Excusez-moi” [frëngjisht - Më falni] a din, unë thojsha, “Pardonne-moi” [frëngjisht - Kërkoj falje] e qishtu ose kur kërkojsha falje.

Më provokojke, po më ka nxitë që me mësu gjuhën. E mandej për anglishtën s'kom qenë shumë e interesume veç dojsa sa me regjistru diçka. Gjimnazi ka qenë supër, si maturante, une si maturante smuna pak. Kom pasë nifarë procesi në mushkni, po mendoj kështu jo ku me ditë sa asi, po e bona ni pauzë se u dufke në spital m'u shtri. Kështu që, mandej ajo më kaloi edhe prapë mbrriva maturën me dhonë me kohë, e maturën...

Anita Susuri: Më falni, në cilin spital keni qenë e shtrume? A ka qenë...

Lirije Pepa: Në Pejë, në spitalin e pullmollogjisë, po mendoj mushkrive.

Anita Susuri: A ka qenë...

Lirije Pepa: Se kom pasë do ndërrime, u ftoha shumë në deti e i mora do ndërrime në mushkni. Mirëpo, kaloi, a din.

Anita Susuri: Deshta me thonë mos ka qenë ndonji vend si lloj... ku keni dalë në natyrë, apo ka qenë ndonji vend ma... çfarë vendi ka qenë?

Lirije Pepa: Ka qenë vend shumë i bukur, edhe ma i zhvillum se që osht' tash po mendoj. Ka pasë ni bukuri të vet natyrore pa u prish. Ka qenë hotel "Korza", mandej u bo edhe hotel "Metohija" në atë kohë, ku është tash "Dukagjini". E qendra ka qenë e rregullume, po ka qenë ma pak e ngulfatne. Tash pak a shumë popullsia a din, edhe qysh kanë ardhë, s'osht' me randësi prej kahit a din, po pak a shumë osht' mbush. Gjimnazi ka qenë klasik, po ka qenë shumë i rregullum për atë kohë. Po mendoj ka pasë krejt ato tiparët si të shkollave që jonë, licetë nëpër Francë andej-këndej, po mendoj qysh mu më kujtohet. E mandej, nashta tash osht' renovu, po ka qenë shumë...

Mandej, në maturë na s'kem shku kërku, kem pasë kajherë orë letrare, shkojshim, dikush shkrujke poezi, diçka. Po shumë kemi qenë kështu të damtum që gjithmonë u duft m'u përzi. Une njiherë kom pasë mbetë në landën e matematikës për vjeshtë që thojnë a din, për shkak se kajherë terminet s'i kuptojsh. U konë aty te ni profesor sërë me shku edhe me sërë çak me qenë në grup për me na pregaditë profesori se ti u dufshe atij me ju asi... A mandej e mora katër, mirëpo... e kështu që kam qenë s'muj me thonë nxanse e shkëlqyshme, po shumë e mirë po. Prej ma të këqijave ma e mira (qesh).

Anita Susuri: A keni pasë... a ju kujtohet që keni shku ndonji koncert apo organizim atëherë, domethonë gjatë kohës gjimnazit?

Lirije Pepa: Po mendon qysh kanë qenë relacionet?

Anita Susuri: Po, por edhe a keni shku në ndonji koncert, a janë mbajt domethonë aktivitetet kulturore?

Lirije Pepa: Po mbajshim koncerte edhe më kujtohet bile mirë. Këto me Vice Vukovin², me plot që vishin prej... ku shkojshim. Tereza Kesovi³ e këto, norma që kësi... e unë kisha privilegj se zakonisht baba i fotografojke shpesh kur vishin, a din kur shkon turma rreth tyne, kështu që shumë kush lypke m'u fotografu me ta. Kështu që, kem qenë nëpër koncerte.

Në kinema kem shku ma tepër. Kinemaja ka qenë argëtimi ma i madh. E dyta, libra kena lexu, po gjithmonë t'u shku dorë mbas dorës, shpesh bar baba kur mendojke që detyrat, na e kishim romanin përfundi {shpjegon me duar}. "Bija e mallkume" e këto do të Shqipërisë që i merrshim ato krejt. Kopertinat e shkyme kanë qenë, veç muj me thonë ka shku gjithmonë libra mas librës.

Se në gjimnaz mandej erdh literatura, mirëpo kem pasë literaturën edhe të sërbeve që shpesh tash e krahasoj këtë *Zmajin*⁴ me këto "Vajet" e Çajupit, a din sërbisht krejt "*Podnem, sretnem, idem*" [serb.: Nisem, takohem, shkoj] a din. Se s'e dini, a dini sërbishten? Mos të asi... po po flas që shumë sende kanë qenë të ngjashme serbo-kroatishen e kom ditë mirë, jo që asi po je detyru me mësu. Për shkak se...

Anita Susuri: E këto librat që po thoni...

[Këtu ndërpritet intervista]

Anita Susuri: ... si kanë mbri ato deri te ju, deri në Kosovë?

Lirije Pepa: Po, shumica.

Anita Susuri: Si kanë mri, prej dikujt apo?

Lirije Pepa: Për shembull, ka qenë ndonji të gjeneratës ma të vjetër që ka shku dorë mbas dore. Bash qetash ka vdek njo e moshume, po na e kem pasë shoqe Zymë Berisha, ajo ka qenë ikë për Shipni, se të gjithë menojshin me ikë, mendojshim që na dojnë shumë, a din po mendoj ajo dëshira e madhe shqip me folë krejt. Une ma së pari kom qenë në Shipni masi u kry lufta. Nifarë organizate që shkum kështu.

² Vinko "Vice" Vukov (3 gusht 1936 - 24 shtator 2008) ishte një këngëtar kroat i muzikës pop.

³ Tereza Ana Kesovija (3 tetor 1938) është një artiste kroate e njohur ndërkombëtarisht. Ajo ishte një nga figurat më të njohura në skenën muzikore në ish Jugosllavi dhe është e njohur për gamën e saj të gjerë vokale dhe stilin operistik

⁴ Jovan Jovanović "Zmaj" (24 nëntor 1833 - 1 qershor 1904) ishte një poet serb. Jovanović punoi si mjek; ai shkroi në shumë zhanre poezie, duke përfshirë dashurinë, lirikën, patriotizmin, politikën dhe rininë, por ai mbetet më i njohur për poezinë për fëmijët.

Anita Susuri: Ajo është hera e parë që keni shku në Shipni masi u kry lufta?

Lirije Pepa: A?

Anita Susuri: A është hera e parë qajo?

Lirije Pepa: Hera e parë. Edhe aty bar e kom ni album kështu në Krujë e do sende. Bar gjermanëve kur ju çova, gjermankës si qysh kem qenë, ajo u çuditke, hera e parë me pa Krujën, Tiranën. 15 ditë kem ndejt se ka qenë një organizatë që punojnë kështu sikur të gjitha. Ti e merr diplomën, po ajo diplomë nëse don nesër m'u bashkangjitetë farë iniciativës diçka. E vizitojshim Krujën, qytetet tjera. Mandej ato kanë qenë edhe në Prishtinë i kom pasë fotografu se ni Arijeta punojke me to, a din, kështu që ka qenë... ka gjana të mira që i kem mësu edhe aty.

A din nëse don me bo najfarë organizimi edhe vet, me qenë ajo që merresh me diçka. Mirëpo, unë punojsha edhe fort nuk më ka interesu. Po mendoj krejt, dallim i madh prej asaj në fëmëni qysh e ke paramendu ti Shqipërinë, në atë kohë e shihshe që ndoshta s'po di... Kem ni grup që bukur mirë u dukshim, a din, po mendoj femrat. Kështu, a din, të rregullume, të veshne, sikur çdo femër që ka qef mos me ja marrë ftyrën dikujt a din. Ato të Shqipnisë pak të kqyrshin... sa u shoqnova me një, ajo ka qenë edhe stomatologe edhe tjetra kur tregojke, tha, "Në kohën e Enver Hoxhës" tha, "nëse jemi la me sapun me erë neve na kanë marr në SUP⁵" {fërkon duart}.

Ajo vet qishtu m'u ka deklarë. Na kem pasë krejt mendim tjetër që na dojnë shumë. Se unë e di kur vdiq Enver Hoxha bash u patëm mledh te tonët, kush kishte televizor që shihet ma mirë për me përcjellë atë aty. Tash me tregu drejt, ajo ka qenë dëshira jonë. Kur Nexhmija e mpshtilli Enver Hoxhën me flamurin kosovarë që ja çunë. Ai na ka deshtë, nejse këto jonë krejt, a din, se Ali Hadrin unë e kom pasë dhondër, ai ka qenë si historian.

Pjesa e Dytë

Lirije Pepa: Aty ka pasë... u formu atëherë universiteti me mjekësi, une kom bo fotografi të ndryshme, kom fotografu nëpër salla të operacionit, direkt ka qenë ajo sllajdi, i çojshim në Zagreb me i zhvillu, se s'ka pasë këtu ende. E fotografitë bardhë e zi direkt për punime shkencore për doktoratura, krejt doktoraturat që i kom punu për kohën kuptohet '75 deri, kur ja nisën këto gjurmët te na me u prish, jo lufta, jo do sende që të shumtëve doktorata edhe ju kanë hup. Se e pyta ni profesor, Agim Veliu, anatom, Alush Gashin shumica e doktoraturave tyne jonë zhdukë. Se qysh i kanë lonë nëpër do banesa, i kanë vjedh i kanë marrë. A din qysh osht' puna zakonisht në mjekësi, njerit i duhet literaturë me pasë sa ma tepër, e kështu që fotografitë që i kom bo kanë qenë këto. Sllajde për kongrese të

⁵ Sekretarijati për Punë të Brendshme.

ndryshme, u mbajshin kongrese me, ke pasë edhe botërore, mirëpo kanë qenë edhe të Jugosllavisë, a din, po mendoj të Beogradit, Zagrebit, a din, tubime të ndryshme. Nëpër kongrese kuptohet merrshin pjesë studentat po edhe profesorat me punime të ndryshme. Kështu që, bojsha fotografi kajherë dokumentare, kajhere sllajdet atyne që u duhsha me punu për ta bardhë e zi, mandej i qitshin normal në projektor. Kanë qenë kushte ma asi... mandej veç mas luftës fotografia te une mo nuk pat sukses. Se të gjithë kishin telefona. Une kom dalë në pension qe dhetë vjet po i bjen, domethonë po i bjen, prit 65...

Anita Susuri: 2009.

Lirije Pepa: Diku qe dhetë vjet që kom dalë, tash bohen dhetë vjet që kom dalë në pension. Domethonë, 2010-ën po më duket.

Anita Susuri: 2010-ën.

Lirije Pepa: Qashtu diçka.

Anita Susuri: Deshta me ju vet...

Lirije Pepa: Kështu që, ka fundi me të tregu drejt fort s'kem qenë të knaqun edhe shumë se u bo nji fare tollovie andej-këndej. Mu prej fotografisë më largun, po më lanë me punu si përcjellëse e ligjeratave për shkak që s'kish nevoj mo fotografi për doktoraturë a për këto. Të gjithë ishin veç asi... jo dolën projektorat, jo dolën llap-topa të ndryshëm edhe kështu që... se drejt në sallë mersha pjesë. Kontakti i parë bar me ni fëmi kur e kanë bo, thojsha qysh bon gjashtë mujsh fëmija m'u bo operacion. E ka bo nji profesor Gazmend Shaqiri, u çudita, a din, se fëmija diqysh... edhe vet ma boni ni pyetje, "A po frigoresh?" Thashë, "Jo", veç pak a din u trishtova diqysh fëmija operacion, a ngjallet a jo. Këto kanë qenë a din.

Anita Susuri: A keni hi edhe në salla të operacionit, pse jonë bo ato fotografi?

Lirije Pepa: Urdhno?

Anita Susuri: A keni hy edhe brenda sallave?

Lirije Pepa: Po, po. Me maskë {bën sikur vendos maskën} me krejt, sikur tash, veç normal mantillin e bardhë, kapelën {shpjegon me duar} kom fotografu çdo operacion gati që është kry prej '75-tës deri në fund të '81-shit, '82-shit, edhe ma vonë u bonën, jo niherë demonstratat, jo helmimet. Edhe në helmime, bar ma kanë pasë marrë aparatit për shkak pata fotografu helmimet. Tollovi e madhe, mendojshe edhe vet që je helmu, se të vike ajo, kur ishe në atë kohë.

Kështu që, këto kanë qenë peripeti shumë të këqija. Ka qenë kur në zyren teme e marrin profesor Alush Gashin e tërhekin midis... Une kom punu me ni sërë, ai ka qenë vizatus teknik, qashtu e kem pasë se jo që dëshira jeme. Ai ka qenë tepër i ngarkum sa i përket kështu... Po me mu, se as unë nuk ju përgjigjsha fort, une e bojsha fotografinë, ai vizatimet teknike {bën sikur vizaton} a din që u dufke.

Kështu që, ka pasë periudha tash a din që thush, na ndoshta nuk jemi përta në atë kohë, mirëpo urrejtja ka qenë, s'kanë pasë qef me të pa ty si për shembull intelektual a diçka, diqysh me nifarë përbuzje. Për shembull, ma bojshin, "Nuk je ti si ato tjerat", shoqet a din, që u shoqnojsa, thojsha, "Krejt të njohta, sa ki që kanë kry..." se kishin kry edhe fakultete edhe farmacistet e para. Mandej, profesor Musa Haxhiu e plot që kanë qenë me renome botërore, s'kanë qenë vetëm te na të njoftun. Mirëpo, ka qenë gjithmonë ajo xhelozia, ajo përbuzje edhe s'kishe çka me bo.

Anita Susuri: E ju mbas gjimnazit a e keni vazhdu naj shkollim ma të naltë apo... se në Zagreb...

Lirije Pepa: Po isha në fakultet veç e lëshova.

Anita Susuri: Po.

Lirije Pepa: Mandej baba tha, "Regjistro" e regjistrova Shkollën e Naltë të Turizmit në Pejë, edhe ato e kryva deri në provimin e fundit e lashë, thashë, "Hajt". Se vdiq, atëherë baba u pat smu edhe kur vdiq ai mandej thashë, "Du me ju përkushtu familjes pak", a din, se të gjithë ishin të ri. Mirëpo, motra dy vjet ma e vogël edhe ajo m'u bashkangjit, kështu që punojshim fotografitë. Kishim punë në atë kohë me ato, çka punojshim ja tregojshim nanës që ajo me u disponu me ato. Kur kishim nevoj për diçka merrshim sa kishim nevoj. Mirëpo, kështu kemi mrrri deri diku, mandej vllavi. Kur erdha une në Prishtinë, ata e morën ma. Se ata jonë ma rrezikantë, a din ma ndryshe ju shkon ajo punë. Thojsha, "Me mbetë une e bllokoj". M'u dha shansa edhe mandej '75-tën kom fillu me punu.

Anita Susuri: E si u bo, si erdhi deri te ajo me shku?

Lirije Pepa: A?

Anita Susuri: Si erdhi deri te ajo me shku ju në Prishtinë?

Lirije Pepa: Iniciator ka qenë profesori Musa Haxhiu, ai në Pejë ka punu, ka punu shpesh herë për publikime të ndryshme, une e mersha aparatit vet prej vetit, mrena që punoj, e bojsha reprodukimin prej filmit e qitsha ni monitor e mandej, i nxirrsha si diapozitiv. Pak u konë e fshtirë se a din në atë kohë ki pasë edhe drejtë që kanë punu me filma ose diku po s'ke mujt me i zhvillu. Gjithë çka punojshim u dufke ose në Zagreb ose diku që ka kanë qenë "Foto kimika" e Zagrebit.

[Këtu ndërpritet intervista]

Anita Susuri: Deshta edhe me ju pyet për atë punën, ku i keni marrë ato kimikaljet, si janë bo ato?

Lirije Pepa: Ato përpara kanë qenë në barnatore. Kur u merke për shembull zhvillusi, u dufke bronz, unifil, krejt. I kom harru tash, më fal, disa po kanë qenë nja shtatë elemente krejt që u blejshin në barnatore. Po atëherë s'ka qenë barnatorja e këtyne po në atë barnatore i kishe krejt këto elemente, edhe e kishim receptin, sikur tash gjellat, e mershim litrin e ujit {shpjegon me duar} e matshim edhe ato niherë e zijshim edhe mandej e lejshim m'u ftoh, i marshim tash prej nishin, mandej dul prej "Foto kimikës" me numra. Po këto që vet i përpunojshim kanë qenë kështu, i mershim shtatë kanë qenë asi edhe krejt, kjo ka qenë për zhvillus, se i kom harru, më fal kërkoj falje po i kom harru.

Anita Susuri: S'ka rëndësi.

Lirije Pepa: Zhvillusin. Mandej fiksiri ka qenë tjetër, aty u merke sulvit e brom e s'di diçka do edhe për to u blejke ajo në barnatore. Ajo ka qenë si kristal edhe u qitke që mandej kur ta zhvillon filmin, e lanë në fiksir për shka që mos m'u fshi po mendoj ajo çka ke fotografu. Se ajo fotografia, kontakti i parë me fotografinë kur e sheh ti në zhvillus të dalin sytë, dalin floktë, a din ajo ka qenë komore krejt me ni të kuqe.

Anita Susuri: E errët.

Lirije Pepa: Aty ku vetëm e kqyrshë a osht' normal e zhvillume që me mujt me gjujt në fiksir, se kom punu në laborator ma tepër e kështu, përveç fotografisë kem punu edhe vet. Kështu që, ka qenë periudhë që bukur fshtirë, shumë ma fshtirë se tash. Se tash jonë bo... i ki ma automat edhe teknika ka mrri shumë. Në atë kohë ka qenë një i vjetër shumë, a ka qenë rus, a ka qenë sërëb nuk e di, një Pier, na i thojshim axha Pier, ai ka qenë fotograf i vjetër. Ai ma ka pasë bo mu një fotografi në mindil, po më ka hup, a din {ngrit dy duart}.

Anita Susuri: A ka qenë në Pejë ai?

Lirije Pepa: Ai në Pejë, mjeshtri i... e thirrshin qishtu, po i vorfun a din, si rrugaç u duke kështu, po ka qenë fotograf i parë në atë kohë, *yyyh* {onomatopeja} sa e di une, atëherë ka qenë i vjetër e le mo... Edhe *majstor* Pero e thirrshin a din, mjeshtër Pero. E ai asi shumë më dojke, a din, edhe ma pat bo fotografinë në asi {tregon pëllëmbën e dorës} u çuditsha qysh bon ashtu fotografia sikur tash që dalin, por në mënyrë primitive ajo ka qenë, zhvillimi e krejt. Qishtu i kom mësu brez pasë brezi.

Shpesh kom qenë edhe kështu ma tinëz babës, kur dikush thojke, "Hin e zhvilloma filmin!" U tutsha mos po pisket, se ai ka qenë shumë preciz, se mos p'e prish a diçka edhe qashtu u msoshja, se pa rreziku nuk mujshe as... Mandej ka qenë punë në atë kohë, për shembull ushtria. U fotofojshin të dilleve. U dufke me ju bo nëpër ato maskat a din, "Mos më harro!" E a din qysh e kanë pasë me

përkushtime të ndryshme. E ato u duhshin në fotokopiro aparat krejt ka qenë një armatë (qesh) e tëra me aparatura të ndryshme në atë kohë.

Fotografi që fotografon në natyrë. Aparati për në plloqë, e qitshe pllakën aty brenda. Kur del, për shembull me familje, kështu deri këtu {vendos duart mbi gjoks} deri në gjysë. Ato, mandej ke pasë edhe kopje që osht' krejt pllaka ma e madhe {shpjegon me duar}, vetëm e kopjojmë kështu me letër, shumë e komplikume po shumë interesante. Masi s'jonë laboratoritë që janë zhdukë gjithka. Se unë edhe këtu i kom punu, në fakultet i punojsha vet fotografitë bardhë e zi. Çak në shumë doktoratura falenderohem.

Kjo ka qenë, po mendoj, sa vjet kom punu 30 e sa, prej '75-tës deri '90 e... sa po i bjen në qat' kohë. Kështu që, personeli mbas luftës nuk ka qenë bash adekuat. A din, shumica diqysh dojke me qenë në vend si drejtor, si dekan. A din, ti e ki ni përshtypje për njerëz që i ke çmu shumë, këta t'u dukshin ma, a din si pionirë të ktyne. Po këta ma tepër me nga mas pozitës, ajo më pengojke mu si fotografe se syni jem kqyrke gjithçka a din. E këto kanë qenë të tëra.

Anita Susuri: E ju pastaj prej Pejës keni shku në Prishtinë...

Lirije Pepa: Po.

Anita Susuri: Si ka qenë ky ndryshimi për juve? Prej Pejës në Prishtinë me ardhë, tjetër qytet?

Lirije Pepa: Mu për shembull Prishtina më ka pëlqy gjithmonë edhe si studente, jo që ka qenë jeta ma asi, kuptohet kem shku nëpër ballo, kem shku nëpër... si studentët. Mandej grupe shoqnore, shpesh mbajshim "Nata e kaltërt" në fakultete, u bojshim fakulteti juridik, se atëherë mjekësia s'ka qenë, juridiku, ekonomiku, filozofiku, se unë e pata regjistru po s'e kryva, pse me të rrejt. Se prapë u ktheva te baba, po mbas vdekjes erdha këndeje. Mirëpo, më mbeti shoqnia, se shoqinë e kem pasë a din, nuk kemi qenë ndonjë kështu që kemi pasë a din, paragjykime, po mendoj baba kështu, jo për asi, moralin e kem çmu me të vërtetë. Mirëpo, ka pasë kështu... jeta po mendoj me dalë, me shku në ballo, kemi shku...

Anita Susuri: A mundeni pak ma detajisht me na tregu si janë organizu këto ballot, çka, çka u bo...?

Lirije Pepa: Për shembull, qe tash unë po ja nisi prej fakultetit filozofik, aty i kemi pasë Genc Nimani e do që kanë qenë kryesor. Kanë qenë në vitet ma të vjetra edhe ata organizojshin, për shembull që "Plavo veče" serbisht e shqip i bike...

Anita Susuri: "Nata e kaltër".

Lirije Pepa: “Nata e kaltërt”. Edhe tash grupi jonë edhe na secila e merrshim ndonji shoqe prej fakulteteve tjera, shoqe, shokë, a din grupin që e kishim, kështu që për m’u bo ma tepër. Aty mershin pjesë edhe profesoriat. Kem pasë profesora të Bosnjes, po mendoj në grupin anglisht po flas, ka pasë profesorë të Beogradit që kanë dhonë mësim edhe shumë asistenta tyne që merrshin pjesë me ne, kurgjo... Atëherë s’ka pasë valle tallava, po ka pasë tango, vallcer, po mendoj *rock and roll*, po mendoj ato çka asi, mandej është ajo {shpjegon me duar vallen} si *yankee*⁶-t që lujnë a, që kapen rresht.

Po mendoj krejt këto, u jepshim na të rejat kishim qef me mësu, me ditë me lujtë e, që shpesh e lujsha rolin e mashkullit me shoqe, për me i udhëheq a din, se motra jeme, lujke ma mirë, po ajo qishtu, tinëz meje me shoqe të veta edhe unë gjithmonë spiuniratsha a din, prej dhomës kur lujshin. Lëshojshin plloqa me këto, me magnetofon, a din e qitshin. Bojshim kajherë edhe *zhurka* [serb.: ndeja] a din, u mbledhshim shoqet e thirrshim dhe ndonji shok, a din, kështu se ma përparimtar në atë kohë, po edhe ka qenë ne atëherë s’kemi pasë havale.

Se une kur kom lindun nana jeme, kanë mbajtur sikur arabkat, e kom ni fotografi bar a din. Aty unë jom një vjeçe kur kem shku, kem pasë na edhe vreshtën tonë, a din të rrushit, shpinë po... Kur shkojshim une... bash më pëlqen ajo fotografi, ku jonë krejt gratë e kojshive me {bën sikur vendos shami}...

Anita Susuri: Peçe.

Lirije Pepa: Çarshafa të zi edhe peçen e kanë pasë. Mirëpo, nana aty më duket edhe unë ngat saj, diqysh si, m’i kanë pasë {prek kokën} pre flokët për me më dalë ma të mira e vogël, se zeshkane kam qenë shumë.

[Këtu ndërpritet intervista]

Lirije Pepa: E bajagi asishne, tani flokët e shkurta, po më pëlqen ajo fotografi si e vogël, gjithmonë me një... ajo kishte qenë këso, qysh i thojmë, hith, une si lule e kom marrë në fotografi, shumë i du lulet a din edhe gjithmonë kam qef me pasë mbi tavolinë një buket, më duket zbrazët tavolina nëse s’kom lule. E kështu po mendoj, a din, ka shumë detale që...

[Këtu ndërpritet intervista]

Anita Susuri: Që ishim t’u folë për *zhurkat*, a ka qenë e zakonshme m’u mbajt kështu shumë *zhurka* apo ju që keni qenë ma përparimtar...?

⁶ Jashtë Shteteve të Bashkuara, *Yankee* përdoret informalisht për t’iu referuar çdo amerikani; është veçanërisht e popullarizuar midis britanikëve, irlandezëve dhe australianëve, dhe nganjëherë mbart ngjyrimet pezhorative.

Lirije Pepa: Një herë në javët, një herë në javë e mbajshim, qishtu vishin këta edhe mandej normal aty ki pasë edhe, dikush e pëlqejke dikon, dikush dikon, sikur zakonisht a din. Ma tepër vishin te njoftimi në qat' mënyrë. Se në ligjerata jo, ligjerata ka qenë shumë disiplinë, kem qenë të disiplinum, s'ke mujt kurgjo me asi... Shpesh u mshefsha ndër bankë kur më vetke profesori a din. Edhe une njiherë e boj ni kiks a din, në vend se me thonë në anglisht, flas frëngjisht ai ma boni pyetje tha, "E Liri?" Thashë, "Une me pasë ditë asi, kisha shku në Francë me studiu e jo këtu". I tregojsha që gjuha frenge më ka asi, kështu që e pata regjistru jo me aq qejf. Temën e maturës e kom pasë gjeografi edhe ato krejt me Nekibe Kelmendin, ndoshta e dini kush është ajo?

Anita Susuri: Po.

Lirije Pepa: Ajo ka qenë një gjeneratë para meje, ajo bar më ka ndihmu, kemi shku në *Dom* [serb.: shtëpi] të Armatës me marrë material, tema ka qenë kur e pata marrë une se u pata vonu pak për temë, e kom pasë turizmin e... *Turizam u Bliskom istoku*, Turizmi në Lindjen e Afërme se u duhsha, a din edhe shqip që me ditë për asi... e nejse, kam harru shumë sende po ajo ka qenë po mendoj... e aty më ka ndihmu Nekibja shumë, se a din shkum bashkë me gjetë materialin. Ajo ni gjeneratë para meje, po ka qenë në mahallë, kojshi, a din e kem pasë në Pejë.

Kështu që, edhe fëmëni shumë të mirë kem pasë, se shoqet e mahallës të gjitha kanë qenë të ni gjeneratës edhe në gjimnaz. Në gjimnaz kam pasë shokë ma tepër, se krejt mashkuj kanë qenë. E në fakulltet kështu me pa jetën qysh osht' këtu, ma tepër jam ardhë për ata. Se a din e pata regjistru pak me vonesë edhe s'kish provime atëherë, provim pranus nuk ka pasë. Nvaret ndonji fakulltet ku ka qenë... për shembull filozofik a diçka që u duft për ni provim tjetër, se aty ko kem qenë na ka qenë pa provim pranus.

Anita Susuri: E si ka qenë Prishtina në atë kohë kur keni studiu ju?

Lirije Pepa: Prishtina ka qenë vetëm Fakulteti Filozofik {tregon me gisht djathtas}, ka qenë balta deri këtu {prek gjunjët} që çizmet i nxirrshim kur dojshim me shku. Na kemi banu në konviktet që kanë qenë afër Fakultetit Juridik, ku është juridiku tash, ato kanë qenë do si kasarne, aty kena banu na shoqet e Pejës, i zgjidhshim dhomat qishtu qe. Kështu që, ka qenë gjeneratë njo Gacaferi, e plot do që jonë... kanë qenë mandej msuse, arsimitare nëpër shkolla këtu, po ushqimin e hajshim shpesh në menze, e mershim ni bon⁷, që me kursy pak a din, se na vike keq prej prindve edhe e ndajshim përgjysë. Për shembull, çka mershim me hongër e dajshim përgjys me shoqen.

Menza ka qenë e mirë kështu edhe në atë kohë. Makaronat më kanë mbet ma së shumti prej menzës edhe ma së mirti i pregaditsha ma vonë, se diqysh i bojshin shumë të mira. Kështu a din, ka qenë,

⁷ Bonat kanë qenë formë e çekut të cilat kompanitë shtetërore i shpërndanin për punëtorët e tyre. Në to kishin të drejtë edhe studentët. Bonat kanë pasur vlerë monetare të cilën ke mundur ta këmbesh me mallra të ndryshme, ushqim, rroba,

nganjiherë dilshim edhe në qytet, në kinema kur shkojshim, kursejshim për kinema, ni herë, dy herë në javë shkojshim në kinema. Shkojshim një herë në javë nëpër ballo. Kajherë s'na lejshin, po i kishim gjithmonë dikun të njofshëm që na shtike edhe pa asi. Në *Dom* të Armatës u mbajke ndonjëherë, e zakonisht nëpër fakultete, në Fakultetin Juridik ma së shumti, aty ma afër ishte edhe...

Atëherë veshja ka qenë e thjeshtë edhe *shminkë* [serb.: grim] s'ka pasë, floktë i mbajshim në atë kohë, floku ka qenë ma kryesori, herë u tapiratke, herë kështu a din, ka qenë ajo kohë. A kështu veshja, se në gjimnaz dihet me *kecelje* [serb.: përparëse] kem qenë. A këtu në fakultet ndonji fund, ndonji send pak ma ndryshe a din, ndonjë xhemper i mirë, këto kanë qenë veshjet po mendoj, ose çizmet çfare t'i blejshin familja, se atëherë s'kish. Ka pasë do që vishin edhe prej Nishit, kanë studiu edhe prej vendeve tjera sërëbët a din, ato pak u dalloshin, për shkak se... edhe na u mundoshim pak me i imitu. S'po di qysh me i përshkru tjerat, veç une p'i përshkruj në atë une qysh i kom pa...

Anita Susuri: Qysh i ndjeni ju. Çfarë filma ka pasë nëpër ato kinematë, çfarë filma janë lëshu?

Lirije Pepa: O kanë qenë filma qe për shembull me Alain Delonin⁸, këto tjerat me Gari Kuperin⁹ me Ava Gardnerin¹⁰, shumicën titujt i kom harru veç kanë qenë aktorët francezë Brizhit Bardo¹¹, Paskal Petit¹², plotë ka pasë kështu që mbaj mend, se shpesh po përsëritën disa. Veç kanë qenë shumë me tema kështu, për shembull mu më pëlqejshin edhe sociale kanë qenë, sidomos francezët, ka qenë kjo me Zhak Sharijen¹³ ni film, që lujke edhe ni aktore, bar më ngucshin, po i përngjan asaj (qesh). Ajo ka qenë ndamje diçka, për martesë a din, po me tema sociale. Edhe italianët kanë qenë, për shembull me Sofia Lorenin¹⁴, këto kanë qenë tema pak a shumë, ma tepër sociale se kishim lexu na në gjimnaz kuptohet në atë kohë. Krejt veprat po mendoj të njoftuna edhe me karakter botëror.

Kur e pata regjistru une pak shkollën e lartë, vike Anton Çetta këtu, edhe s'kom qenë e sigurtë... po dal prej temës veç po du m'i lidhë ngjarjet. Këto gjermën "ë" a din, nuk disha ku përdoret fort, po mendoj s'jom konë e sigurtë, edhe ky na shtini me bo ni temë kështu se e kom pasë edhe Fatmir Lamën në klasë e kështu. Profesor Anton Çetta tha, "Ni temë që..." edhe une e bona "E puthura" e Mihail Gramenos, sigurisht e dini ju që e keni kry gjimnazin.

Anita Susuri: Po...

⁸ Alain Fabien Maurice Marcel Delon (1935) është një aktor dhe biznesmen francez.

⁹ Gary Cooper (1901-1961), i lindur si Frank James Cooper ishte aktor amerikan.

¹⁰ Ava Lavinia Gardner (1922 - 1990) ishte një aktore dhe këngëtare amerikane.

¹¹ Brigitte Anne-Marie Bardot (1934), është një aktiviste franceze për të drejtat e kafshëve dhe ish-aktore dhe këngëtare.

¹² Pascale Petit (1938) e lindur si Anne-Marie Pettit është aktore franceze.

¹³ Jacques Charrier (1936) është një aktor francez dhe producent filmi, i cili është marr edhe me pikturë dhe qeramikë.

¹⁴ Sophia Loren (1934) është aktore italiane.

Lirije Pepa: Edhe tash veç e pritsha çka po më jep, se Anton Çetta ka qenë shumë i respektum prej neve, thotë, “Lirije ti je shumë... me qenë gazetare i ki fjalitë e shkurta, shumë a din, me domethanje”. Tha, “Po nëse jo mundesh me lexu Alberto Moravinë¹⁵”. Une e kisha lexu se motra jeme i mshefke pi meje. Une e kqyrsha {ul kokën} ku i ka lonë edhe i lexojsha. Se sërbisht na vetke profesori a din edhe une e kom lexu këto a din sërbisht, ai u çuditke, si kemi pasë na literaturë po jashtë literaturës.

Moravinë, e shumë të tjerë, italianë a din, po edhe i kom harru tash, po do gjana më kujtohen. Edhe thojke, thojsha, “Unë jam pak jo kureshtare veç ngutna” thojsha, “profesor e kom lexu” a din, thojke, “Mirë, nuk je sigurtë në...” thojsha, “E di” prandaj kisha qef bar dikush i mirë me më tregu. Se në gjimnaz gjithmonë një profesor Riza Bicaj, na jepke njish nëse e zhyt ato, une e zhytsha mos me ma korigju, për shkak që qe diqysh kisha përshtypje që s’jom e sigurtë edhe e marr nish. Ai ma qitke nishin për tjetër gjo.

Çak edhe në temë të maturës e kom pasë pak të ulne maturën për shkak të gjuhës shqipe, për shkak se une... kompleks ajo, se njeri duhet me shku edhe m’u mësu në gabime, po ato kanë qenë komplekse që u munojshe në një mënyrë me i shëru ndryshe a din. E ajo gabimisht ka qenë çka bojsha po... qishtu. Kështu që, dola në pension tash jom e knaqne, po mendoj s’më bjen kurrë në mend për aty, se shumë keq janë tregu, po mendoj kuptohet këto premtimet e ndryshme e kurgjo s’realizojnë.

Anita Susuri: Deshta me ju vet edhe diçka. Ju prej ‘70-ave deri ‘90-at keni punu në Qendrën e Mjeksisë...

Lirije Pepa: Prej ‘74-tës, po në ‘75-tën që mirret si asi deri në pension, pa ndërpre.

Anita Susuri: E si ka qenë në vitet, këto vitet ‘81, prej viteve ‘80-ta pastaj, demonstrata e këto...

Lirije Pepa: Kanë qenë tepër të fshtira.

Anita Susuri: Si ka qenë për juve?

Lirije Pepa: Se aty e murën krejt. Une... ma bojke Alush Gashi... se e kem pasë, zyrën e kom pasë në institut, po mendoj ku u mersha, se profesor Musa më mur aty për shkak ish laborator, mandej kush më thirrke, veç me telefon më thirrke me fotografu. Aty e murën krejt dekanatin, e morën serbët. Sekretarja serbe, {numëron në gishta} krejt kanë qenë komplet serbë. Kështu që, një situatë tepër e fshtirë. Ndërkohë, unë isha me Alush Gashin në një zyre ku pishim kafe kajherë edhe dikush na shpiunoi. Erdhën Alush Gashin me e marrë, une në qat’ kohë kisha fotografu në ginekologji, ni rast të një tumor edhe ndërkohë kur e morën Alushin, se e ngrehshin zhag.

¹⁵ Alberto Moravia (1907 - 1990) ishte një romancier dhe gazetar italian. Romanet e tij eksplorojnë çështje të seksualitetit modern, tjetërsimit shoqëror dhe ekzistencializmit.

Erdhën, thanë, “*Ko je Aljuš Gaši?*” [serb.: Kush është Alush Gashi?] Ai ka qenë profesor i anatomisë edhe ka qenë ministër i shëndetësisë një kohë këtu në Prishtinë, tash nuk osht’ mo, i LDK-së ka qenë. Ndërkohë e fotoqrafoj {bën sikur mban aparat në dorë} në shkallë tu e ngreh zhag, po prej a din {lëviz duart} dora të livrit edhe krejt, mirëpo shihet silueta e tij. Edhe nejse tona vike milicia njo-dy aty edhe ky që punojke me mu i ka marr edhe i ka rrit fotografitë që i kom fotografu une në gjinekologji edhe këto të Alushit. Se ky shkojke ma herët, e kem pasë zyrën e përbashkët, mirëpo laboratorin të veçantë, a din ku punojsha në të. Edhe ai shkojke në shpi, unë rrisha mbas edhe i shikojsha fotografitë. Se Alush Gashin e morën e ja patën thy dhomin e, e patën malltretu.

Edhe mandej po i tregoj une Alushit e këtyne a din, qysh ka qenë situata, a din, thojke, “Hiç mos ki dert ami ato fotografitë” po u frigosha m’i marrë. Alushi ma boni tha, “Lirije mos gabo me lëshu ti punën” edhe une dej në momentin e fundit. Shkojshim në dekanat, në dekanat krejt sërbe, krejt struktura e ndrrume. Porfesorat do i kishin marrë nëpër asi, ju kishin mshelë ordinancat, po mendoj ato qysh i kanë pasë të ndame ku punojshin, mo as nuk te thirke kërkush. A me fotografu edhe me të thirr ti... kisha privilegj se shkijet a din qysh, jo që më dojshin, po tu mendu që kanë punu me atë Lubën, se ai e ka mbyt veten pastaj, q’ai që ka punu me mu.

Me revole vike në zyre, kajherë a din u konë tepër i fshtirë edhe hajt u shukatsha, thojsha a di, jo me ju frigu. Kur më bojke pytje, “Çfarë dallimi, ju nuk jeni si shqiptarët e Shipnisë” a din, thojsha, “Une për veti s’ muj me thonë *albanka* [serb.: shqiptare], po shqiptare edhe *Albanija* për ju, po për neve o Shqipëria”. A din, bojke pytje provokative, veç kajherë u shtysha a din, me tregu drejtë. Sjom fort e durushme, s’kom qenë sa i përket këtyne sendeve.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Tregutë për vitet ‘70... domethonë, ‘75 kur keni fillu punën aty, çfarë probleme tjera keni hasë, a keni hasë në probleme që keni qenë shqiptare apo si kanë qenë marrëdhanjet?

Lirije Pepa: Paj, kqyre, kom pasë probleme meqenëse s’jom dorëzu kurrë. Ky që ka bashkëpunu me mu ka qenë vizatus teknik. Ai ka qenë si farë, jo drejtor, po qashtu e ka ndi veten që krejt shqiptarët diçka ju përlushin. E më vike inati se bojke dallime, i mledhke krejt shoqet aty, se zyret i kemi pasë në fillim të ndame, mandej kur shkum... në dekanat e kem pasë zyrën. Mandej kur shkova në institut atje e kem pasë pak të përbashkët. Po, ai u konë qishtu nifarë tipi injorant, ni tip që vetëm veten e ka çmu. Mo merre me mend kur për Vit të Ri ka lypun krytë e shqiptarëve, qashtu që tregojnë, se ka qenë shumë i ngarkum, a këndej para meje nuk ka pasë. Probleme s’kom pasë.

Në punë çdo fotografi që e bojsha u tutsha po më del, se a din qysh ato nuk përsëriten, mirëpo kisha sukses a din. Kur ishte kongresi me karakter jugosllav ose diçka vishin tre-katër ditë, mo krejt kohën kemi qenë të preokupum, t’u mbaru fotografi, t’u mbaru sllajde, t’u reproduku studentëve çka kanë

punu. Për shkak se u dufke dikun me i ekspozu, kështu që i qitshin ata qishtu me... atëherë ka qenë vetëm kjo diapjektori, edhe dikush rrike me to. Për shembull, ky si vizatus teknik, ky rrike, i montojke a din, sllajdet. Une fotografimin, kur u bojke ndonji rast a din, me karakter që thush botnor ose diçka, une fotofojsha.

A din, po mendoj ato detale po ka marrë edhe ky Dedushaj shumë fotografi, a din, si dokumentacion po s'osht' me randësi. Kom aty-këtu ndonjo edhe do që m'u kanë djegë në Pejë krejt, se a din qysh i len njeri albumet e vjetra mos m'u bajtë që shumica jonë shkatërru. Mirëpo, në përgjithësi, prapë njeri p'i konpenzon, ku po e gjen ndonjo po e reprodukon e kështu që mirë.

Anita Susuri: Në atë kohë më duket që ka qenë ma e lehtë me udhëtu jashtë vendit, po edhe nëpër Jugosllavi, a keni udhëtu ju edhe ku keni udhëtu për herë të parë?

Lirije Pepa: Për herë të parë kom udhëtu në Sarajevë me babën, atëherë kom qenë në moshën diku dhetë vjeçe. Me gjithë motrën na pat marrë. Se baba e ka rritë ni djal të axhës, ai që e ka pasun e ka rritë. Kështu që, na ka mbet me Sarajevën shumë asi... që edhe në atë kohë edhe nana jeme ka shku, kanë qenë edhe në Sarajevë me çarshafa {tregon rreth kokës}, çarshafë i kanë thonë atëherë, jo sikur namazbezat, po kështu ni veshje si arabkat, me til përsipëri e kështu. Nana ka qenë sa herë me babën, e neve na murr baba nihere, sa e kisha kry tetëvjeçaren, une me gjithë motrën.

E udhëtimi i parë ka qenë '60-tën në Ulqin, kur baba na ka çu mu edhe motrën edhe vllaun e madh në deti. Kem shku me çikën e hallës e krejt, atëhere pllazha ka qenë e zbrazët. Vetëm teatri më kujtohet në atë kohë, se a din thojshin aktorët e teatrit, se shumica kanë qenë edhe pejonë që kanë marrë pjesë, kështu që kemi pasë fotografi. Mirëpo, kureshtarë kom qenë se i njifsha shumicën, mirëpo udhëtimi i parë ka qenë me anë të Çakorrit me autobus patëm shku në deti. M'u njoftu me detin edhe na s'kemi... në Pejë ka pasë Bistrica e kështu, po ajo ka qenë mramje, kështu. Edhe na aty shohim deti, notojmë normal, thu se jemi mësu nëpër shkolla.

Ajo ka qenë moshë... e kom diku fotografinë, po mendoj me flokë të shkurta, me asi, veç shumë të reja, merre me mend ti sa e kom kry tetëvjeçaren 14 vjet, 15 tek në fund të vitit i mbusha, a din. E kështu që ka qenë... e aty unë jom ftoh shumë se kur mrrinëm në Çakorr ai i autobusit tha, "Unë s'garantoj..." se bike shi shumë, "kush don me shpëtu jetën le të zhdryp në komë", a din me kalu atë pjesë. Motra e madhe nuk zhdrypi, une zhdrypa, qaty ma së pari e kom marrë të kallunit e kësaj {prek fytin} fytit. *Zapaljenje grla*, thojshin, kalljen e fytit. E mandej e pata marrë ndrrimin, si maturante, ajo ka qenë, ndonji grip që më ka asi, mirëpo mirë ka kalu, apet qysh kom mendu, situata mirë.

Mandej në Sarajevë, po më dukët që edhe ma e vogël në Sarajevë po tash s'po më kujtohet udhëtimi me tren. Kemi udhëtu ka qenë Qira njifarë treni që u konë prej drrasave, si nëpër filma a din ata aksion, kaubojski (qesh). Aty shkum qishtu më kujtohet, jom shku kah... neyse pi Kralevës, s'di do vende tjera a din, bajagi rrugë e gjatë.

Anita Susuri: Qysh ju ka dok juve, çfarë përjetimi ka qenë ai në tren? Kur e keni pa trenin?

Lirije Pepa: Ka qenë përjetim shumë asi, veç edhe ka qenë një... baba jem e ka pasë za... tada shumë... nëse u ndal treni diku, ai u shku na ka ble diçka. Po qasi guzhve ka qenë në tren, sa une u njoftova me një serbe. Pak a shumë ma don shoqinë s'di çka o puna. Edhe tash ajo po më vet, “*Šta ti radi majka?*” [serb.: Çka të punon nëna?] A din, “Çka të punon?” Une i thashë, “Nanën e kom mësuse”. Aty e pata rrejt a din edhe nejse ja lëshova, nana vet ish shumë e trashë, ja lëshova vendin për m’u ulë. Tash baba ishte ndjirs t’u na gjetë vend, se udhëtimi i gjatë prej Pejës deri në Sarajevë, ni natë e ni ditë udhëtim ka qenë. Me Qiro, ai treni që është... me drresa ka qenë, mirëpo si përpara qysh kanë qenë lokomotivat, ma tepër i përngjajke.

Edhe baba tha, “Kush...” unë edhe motra, tha, “Kush asi...” thashë, “Une”. E pranojsha gjithmonë gabimin tha, “Del rri në korridor”. Po mendoj kjo ka qenë nifare si asi dënim. Se tash më vike keq qysh m’i thonë, unë u bona shoqe me atë sërben (qesh). E rrejta që e kom nonën msuse se më vike inat (qesh). Edhe qishtu që, po mendoj. Edhe tona mas ni kohe, motra s’u përta me mu veç thojke, “Ti e ki fajin”, thojsha, “Po de, une e pranoj” a din. Dikur baba na shtini prapë [brenda] a din, u shliro, se ajo u ndal nifare stacioni, shkunë ata prej Krlevës dika tjetër, kështu që u shlirova a din. Më jepke këshilla baba, se pak jom konë e luhatshme, a din ma thejke mendjen dikush gjithmonë, jo e sigurtë, a din. Thojke, “Mos lejo me ndiku dikush te ti”, a din.

[Këtu ndërpritet intervista]

Anita Susuri: Deshta edhe... tregut për vitet që keni punu në universitet, domethonë atje...

Lirije Pepa: Në fakultet.

Anita Susuri: Në fakultet, si ka vazhdu ma tutje, me çka jeni preokupu, a ka qenë veç ajo puna ju, a jeni marrë edhe kështu me fotografi si...

Lirije Pepa: Me fotografi, për shembull kur ka pasë raste që janë ardhë, doktoratura e ndojkujt, publikun, e ki fotografu personin...

Anita Susuri: Po mendoj, në dyqan, a keni punu mo, a jo?

Lirije Pepa: Ja-a, une s’kom punu mo. Se vllau ka punu në muze, pat ardhë edhe ai në punë në Muze të Revolucionit, mandej e çeli dyqanin, mandej prapë me asi, ku edhe fëmijtë, këta maturën secili të kryme, studenta jonë, po kanë qefë edhe këta me punu me fotografi.

Anita Susuri: A kanë qenë edhe ato vite kur e keni taku Nanë Terezën?

Lirije Pepa: Eh, Nanë Terezën e kom pa '75, kësi '79-tën e kom taku.

Anita Susuri: Si ka ndodh?

Lirije Pepa: Ajo kurgjo... kjo motra më mur, qysh kem në shpi, me ni fund të teksasit, me ni maicë. Dhurata, "Hajde..." ajo ka qenë e smutë Dhurata diçka, "Hajde" thashë, "se ti gazetare mundesh intervistë të vyn" a din, Nanë Tereza. Edhe qekjo ka qenë biseda me to, se e fotografojsha une me... qysh o bre ky kompozitori ka vdekë tash me "M", i Prizrenit. Ai e ka pasë Nanë Terezën shoqe, Mark, jo, nuk o Mark Kaçinari, nuk osht' po i vjetër, moshës vjetër, mo gjeneratë me Nanë Terezën.

Anita Susuri: Nuk po e di tash...

Lirije Pepa: Neise, po mendoj aty i kom pasë fotografu edhe intervistë me fëmijë ajo edhe qajo kur m'i veti qato fjalë. E motra më thirri, edhe une shkova në kishë, e mora aparatit. Kur erdh Nanë Tereza, e pritshim a din, si nusen kur e pret. Kur erdh ajo ka ora nantë, ministër i informatave ka qenë atëhere ky Nehat Islami edhe neipse vijinë, do profesora, e presin Nanë Terezën edhe ky ka qenë i kishës që është ky i njoftun... ja harrova emrin këtij kryesorit në Shën Ndue edhe Nanë Tereza kishën.

Anita Susuri: A janë këto, a kanë qenë në Prishtinë këto kishat?

Lirije Pepa: Kisha ka qenë këtu {tregon me gisht majtas}, që është te parku ajo. E në qat' kishë patëm ndejtun edhe pritshim deri sa e fotografova e krejt, e mandena na interesojke, a din kureshtare me pa sa ma tepër Nanë Terezën edhe plus mburrje se thojsha kërkush s'e ka pa. Jom e para që e kom pa prej publikut kështu jashtë kishës, jashtë institucioneve tjera. Se Rugova mandej, ma vonë, kjo ka qenë ma vonë. Une '79-tën tamam çmimi Nobel kur ju nda për paqe.

Edhe neipse tani kish shkru kjo Dhurata artikuj, thashë barem, "Duhesh m'u mburrë" se a din... jo ajo më përmen që kom qenë iniciatore që e kom thirrë edhe mu ajo motra. Edhe këto kanë qenë fotografitë, kur e luta profesor Belegun, në transfuzion ka punu, thashë, "A bon, bonma një pozë" se i thirra unë profesorat për me qenë a din, thojsha sa ma tepër prezent. Edhe ka qenë gruja e Ymer Jakës, me fëmijë. Kanë qenë aty-këtu a din, qasaj rrethit afër kishës që jonë.

Edhe mandej, kur më pyti kjo, "A je ti gazetare?" Në gjuhën angleze ma boni atë fjali, unë fati që i disha ato, ma të freskëta. "Are you from a newspaper?" Thashë, "No, I'm a photographer" [Ang.: Jo, jam fotografe] a din, edhe me kaq asi. Thashë, "You speak Albanian? A din shqip?" Tani ma boni, tha, "Shqip shumë pak", qe qet fjalë. Ndoshta keq që po e përmendi, po ajo prejardhjen shqiptare, po e ka harru gjuhën, shumë herët ka dalë jashtë. Se ajo Gonxhe Bojaxhiu, dikush thotë që në Prizren ka lindë, mandej në Shkup. A din, pak a shumë do biografi, pak ma...

Neise nuk p'i hi asaj temës, veç une mburrna që e kom pa, edhe ni gru shumë modeste, e vogël, me ato rrudha, shumë me të lonë përshtypje që është me të vërtetë një gru shumë, po mendoj, bamirëse, u shike bamirësia e saj në ftyrë. E qetë, a din, që s'i ka lonë përshtypje a duket bukur, a nuk duket bukur, kryesorja ajo ka qenë madhështore diçka për mu. Qe, ajo ka qenë kontakti me te. Mandej, normal që kom pasun, kom shëtitë, une gjithmonë pushimet i kom kalu, që thush... më pyte, ma bone ni pytje, “A ke dalë?” Kom dalë, qat’ vit kom qenë në Spanjë ‘79-tën, me Dhuratën kemi qenë në Palma de Majorka, me anë të Beogradit.

Kem shku me autobus dej në Beograd. Se kjo u tutke prej aeroplanave, Dhurata, mirëpo në Beograd, mandej me “Avioagent”, më kujtohet asi, drejt në Palma. Atëherë kanë qenë ma të rrallë shqiptarët që kanë udhëtu jashtë atje. Edhe une veç... përveç ni pejon që e kom pa, Shala mbiemrin edhe thashë, “Dhuratë piskat ti, ‘Lirije...’ a din, thirrëm, në qoftë se o shqiptar e kthen krytë”. Kështu që, shumë mirë kem kalu, vizitojshim qytetet afër. Se në Palma ish San Arenall e na e kem pasun këto... aty jem taku edhe me këto babën e Riki Martin.

[Këtu ndërpritet intervista]

Lirije Pepa: Eh Hulijo¹⁶, ai bukurosh, edhe neve na kap dorën aty {shtrin dorën}.

Anita Susuri: Hullio Igllesias e keni taku?

Lirije Pepa: A?

Anita Susuri: E keni taku Hullio Igllesias?

Lirije Pepa: Po. Veç ai na kap dorën kështu a din, edhe na, “U Hulijo!” Aty takohem edhe me ni drejtor të Zvicrës, i përngjajsha une gruës vet, ai neve darkën me Sangri, a din Sangri ka qenë një lloj pije e Spanjës me flakë a din, edhe me mishna të ndryshëm. Edhe dy beogragjanka [srb.: beogradase] ishin me ne, ato kishin qef m’u shoqnu se diqysh kem pasë fat, gjithmonë na delke diçka mirë a din. Kështu, 15 ditë kemi ndejt atje mandej u kthym në Beograd.

Mandej, Greqinë e njoh bukur mirë, shumë, bregdetin po mendoj. Në Athinë kem qenë, se në Lutrak patëm shku, osht’ njifarë vendi gati në kufi me Shqipninë. Greqinë 80 përqind e njof, se Spanjën s’muj me thonë, veç Palma de Majorka. E Jugosllavinë e njoh krejt mirë, gjithka, se nëpër bregdete t’u shku s’ka nevoj m’i përmend veç shumicën. Mandej, kam qenë në Belgjikë, vllau ka qenë në Bruksel, në Bruksel jo po në Kotrijk, mandej ka kalu në Bruksel. E prej atyhit une me gjithë çikën e djalit hallës, se ajo a din, sa e kish kry maturën erdh me mu, për shkak se baba i vet kish qef, ajo kish qef me shku në Londër. po a din si prindët që s’kanë qef.

¹⁶ Julio José Iglesias de la Cueva (1943) është një këngëtar, kompozitor dhe ish futbollist profesionist Spanjoll. Ka shitur më shumë se njëqind milion albume këngësh në të gjithë botën, në 14 gjuhë.

Edhe shkum, gruja vet thojke... ajo osht' belge, tha, gjithmonë ma bojke, "Prej Belgjikës osht' shumë afër Parisi" edhe tash tha, "Mundesh me udhëtu". Po vllau punojke diku tjetër, ajo punojke, kështu që u dashtë na me shku në konzullatë të Francës me pyet, se s'na jepshin vizën. E vllau thojke, "Ju shkoni edhe pa viza, nëse s'ju jepin vizën bohuni toshë. Nëse ju kthejnë, kurgjo, s'ju marrin në burg a diçka". Edhe... ndoshta s'ju intereson kjo? [i drejtohet bashkëbisedueses]

Anita Susuri: Jo, jo, tregoni, po.

Lirije Pepa: Edhe na shkojmë në konzullatë nuk na jepin vizën. Hypim në tren në qytetin Lilë, aty e blejmë biletën për Paris. E blejmë biletën aty edhe kur vijmë në Lilë osht' Moeskro, ni qytet gjysë Paris, gjysë Francë, gjysë Belgjikë. Para se me hi në Lilë. Ai na bon, "Où visa?" [fr.: Ku është viza?] a din, tash une, "Je ne sais pas" [fr.: Nuk e di], po bohem toshë, kishë s'po di. "Visa?" A din, ajo franqezja ish e gatë edhe ish njo, s'dojke me na lonë. Tash këtij belgi i thash, "Je veux visiter Paris" [fr.: Dua ta vizitoj Parisin], a din edhe kem m'u kthy a din, edhe anglisht barem kajherë folshim që, se ata fort anglezët nuk i... Edhe dikur tha, "Hajt!" {lëviz dorën}.

Edhe na aty në Lilë e blejtëm biletën për në Paris. Në ora tetë u nisë treni, me tren patëm shku, pa e njoft Parisin hiç. Veç kjo gruja vllaut e blen direksionin {sikur lexon diçka prej dorës} aty kur mrrin në stacionin e Parisit, aty shkum në tualet. U rregullum pak, se u patëm vesh kështu, a din që mos me asi... Kom edhe fotografi të Francës. Edhe çka me bo tash me Aritën, e morëm direksionin edhe s'patëm kurrfarë problemi m'u gjind. Çka din ti, prekshe njo, tu çelke, ose s'tu çelke a din, në qytet të huj kurr s'ki qenë veç në ondërr. Edhe ndërkohë tash aty kur mrritëm, thashë, "A din çka Arita?" Thashë, "Po i hypim kësaj metrosë".

Në metro, e kishe çdo vend për shembull tash dojshe me shku në muze, shkum në muze, zbret aty. Tana në opera patëm shku operën me pa, po mendoj vetëm asi, se ditë ish. Aty bar njoftohem me dy profesora të Anglisë, me ta anglisht folshim, se atëherë e kisha anglishtën ma afër edhe ajo e dike. Ata thanë, "Prej kahit jeni?" Na s'dishim me thonë, veç thojshim, "Kosovo" s'dishin, thojshim, "Dubrovnik" a din, "Dubrovnik" që prej Jugosllavisë, "A Dubrovnik!" Ja nisi ai, na dha adresën, tha, "Nëse rrini sonte këtu..." në darkë me na çu. Dy profesora me cilindra bar, i kanë pasë {prek kokën}, ata jevrej [hebrej] po që kanë jetu në Londër. Edhe nejse po na ju thamë kishe po kthehemi, edhe nuk, a din, nuk dulëm.

Ish nji kafe aty franqeze {sikur mban filxhan në duar}, si zakonisht, përballë operës. Në operë hinëm veç mi pa ato {përshkruan me duar} krejt prej arit, a din, Parisi bre vlla! Gjithmonë më ka pëlqy. Prej metrosë Champs d'Elysee, aty i ki pasun krejt ato që i qesin shpesh nëpër kësi. Tana Notre Damin, qeto çka i kemi vizitu po flas, tana George Pompidou ajo qendra aty ku mbledhën të gjithë, s'po di mo me përshkru gati çdo vend. Para muzeut, muzeu ka qenë mshel, kështu veç jom fotografu aty para fontanës, se tash ma vonë i kanë bo fontanat edhe prej xhamave, po mendoj kur kem qenë na, se

normal me pasë hi në Luvër s'ishim dalë gjithë ditën. E na për dy ditë, që shihet Parizi qaq, a din ish... po të bojkë për veti.

Tani Pallati i Vogël, Pallati Grande, Petite Palace, aty krejt dyrtë e arit, a din do detale që kështu shumë, tu dukshin interesant. Shkum tanaj edhe te Ajfelli {ngrit kokën lart}. Po kjo e kishte atë smundjen, Arita, i pengojke naltsia. Aty u njoftum me një, jo francez po... arap jo, algjerian. Qaty ai thojke, "Jo, mu Roma, më pëlqen ma tepër" na thojshim, "Jo valla Parizi i bukur" a din nisëm pak kështu. Edhe aty veç Ajfellin, se diçka aparatin që e kishim, se se mora une temin po e kish marr kjo, po poza jo ashtu qysh me thonë, po mirë, se te vllau kur ishim, ai na fotografojke, vllau.

Kështu Brukselin e këto, Parizin, po menoje qaq, s'muj me thonë... se me ndejt ti me vite edhe s'mundesh me e pa a din. Mirëpo, ato që më kanë interesu, kryesore, qendrën po. Mandej Dera e Triumfit, kem shku në komë deri te Dera e Triumfit. Plus edhe kjo "Channel", Koko Channeli më ka pëlqy, sidomos parfemat, "Channel 5" e përdorsha a din, në atë kohë. Aty i kem pasë pa, femnat kem qef, jo parfema, jo... E kështu ka qenë, qekjo ka qenë e Parisit.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Gjatë vitit '81 besoj, keni qenë duke punu...

Lirije Pepa: Duke punu dhe ka qenë tepër problematike.

Anita Susuri: Edhe qysh ka qenë për juve ajo, në mars a fillo, demonstratat...

Lirije Pepa: '81-shin, mu më erdh edhe vllau në Prishtinë, u punësu në muze. Ndërkohë, kur shkojshe në punë, u dufke gjithmonë... bar me profesor Malokun, ai ka vdekë, ai ka qenë patolog, na kontrollojke policia te instituti, ne jse letrën e njoftimit krejt këto. Ka qenë ni situatë, ni qetësi absolute, ku s'mujshke kurgjo. Këta patologët... tash ranë do raste në Podujevë që i mbytën të Pojatës, u dufta m'i fotografu, na i çojshim fotografitë në Zagreb atëherë me i bo, a din. Ata a beson, i kanë marrë ato fotografi, po get, edhe s'kanë lonë...

Se ato i mersha në formë direkt, ka qenë Lume Gashi edhe ky profesor i patologjisë që ka vdekë Maloku edhe fotografojshim, ma rujke dikush në lift kur hishim për mos me na pa se krejt tinëz i bojshim. Fotografitë që ishin me pluma, me flamur të Shqipnisë e me krejt këto. Këto kanë qenë disa pjesë prej tyne që kurrë s'i kem pa ato fotografi, mirëpo kanë qenë të fotografume. Tana...

Anita Susuri: Nuk jonë zhvillu kurrë, po mendoni?

Lirije Pepa: Jo, ato janë zhvillu në Zagreb, po këta kur i marrin {sikur shfleton} ato, i kanë kontrollu edhe i kanë asgjerasu. Mandej, ka qenë situatë kështu... qeky ma së pari që punojke me mu thojke, “Mos rri ti me ata” a din, serbisht ma bojke a din, tha, “Une ty kurr nuk asishne, veç s’ki nevoj” demek që ai na ngjike shumë mirë, krejt bisedojshim po, u konë i ngarkum. Mendojke që erdh koha e tyne. Kur e kom pa {prek brezin} revolven tu e bo kafen ai, se kafet i bojshim nëpër reshova na vet, a din. Po ai... revolja. Jo, që jom tutë, se ai s’mundet me më mbytë, veç çfarë qëllimi ka qenë ai me revole me të ardhë në zyre.

Çak do profesora edhe folshin shqip me mu edhe do kanë qenë të Pejës, Shqepanoviq e do të stomatologjisë, a din, që më ngjishin, se e ngjishin babën, e kanë njoftë. Shumë kush na ka njoft, tash na kena qenë familje e njoftun në atë kohë edhe kem, jo që kem bashkëpunu, po kem folë normal, si zakonisht. Kur më çojke baba najsen me marrë... se po kaloj prej temës veç, kalova në atë temë krahasim me bo. Unë e kom pa Rankoviqin ‘55-tën, kur ma ka bo baba, “Qe qeky osht’ Rankoviqi”. Ka qenë me mantill si të bardhë {përshkruan me duar} edhe me sheshir. Mu s’mu ka duk atëherë çka asi veç i thojshin...

Anita Susuri: Ka qenë në Pejë a?

Lirije Pepa: Në Pejë, Pejë. Se ai e ka pasë afër Patriarshisë jo, po ma anej, shpinë ku jonë mledh aty sërbët se shkojshin edhe gjuetarët, u konë dom i gjuetarëve ku fotorafojshin derra të egërr e krejt këto edhe ai vike shpesh. Peja ka pasë sërbë mjaft, Peja edhe Prizreni më duket, se a din i di edhe shumë pejonë kanë jetu në Prizren. E kështu që, marrëdhanye nuk kemi pasë shumë të këqija pse na kanë njoftë, se unë kom fotografu në atë kohë edhe nëpër shpia për Vit të Ri, te serbët Bozhiqin [Krishtlindjet ortodokse] e kanë pasë thirrshin a din, na punojshim atëherë për asi...

Mirëpo, në atë kohë s’ka qenë aq nacionalizmi, ka qenë, po na s’kem, s’kem pasë do... baba thojke, “Mos u shoqnoni shumë” se tash shoqe në gjimnaz aty-këtu. Se thojke, “Nuk e njihni ju” a din, që demek mos e vazhdoni ma tutje. Këto kanë qenë edhe këtu kom hasë, shoqni kom pasë edhe sërbë, shumë mirë kom kalu, po gjithmonë ma bojshin ato, “Nuk je ti sikur këto”. Thojsha, une jom nisoj, se a din pak na nënçmojshin. Ka qenë nënçmim i teprum. Po, mendun në qat’ kohë që u bonë ata krejt. As s’kom pasë marrë rrogë as kurgjo. Për ni gabim ma të vogël sekretaresha thojke, ma ndalke 15 përqind rrogën.

Anita Susuri: Në vitet ‘80-ta?

Lirije Pepa: Se e patëm në atë ndërtesën, na çunë ku është biblioteka e studentëve tash, ka qenë pak ma e ndame, se ma mshelën zyrën mu edhe une rrishta në Dekanat. Kur thirrshin me fotografu, une e bojsha kërkesën, ata s’kishin s’mi blejshin ato. Kështu që, përveç studentëve të vitit... kur kanë qenë sërbë se ata më njëfishin krejt, që e kom pasë bo unë ato për studentë, mramjen e, a din apsollventave që e bojnë, ato atyne veç i fotorafojsha une, normal e pata marrë aparatën prej vllaut, i punojsha te

vllau fotografitë që... edhe tanaj nëpër asi... Ka pasë kësi raste, apsollventat e këto, mirëpo, hala isha në punë, deri në fund. Kur u bo lufta...

Anita Susuri: Deri '99-tën keni punu a po?

Lirije Pepa: Deri... hiç s'kom ndërpre une, po qatëherë kur u bo, unë e pata ni grip, bash jom konë keq prej gripit, edhe qatëhere erdhën, u mshelëm. Unë mbeta vetëm në banesë, se banesën vllaznit ma kanë ble, këtu. Edhe mandej vllau po thotë, "Hajde, me ardhë gjithqysh!" "Qysh me ardhë?" Me pixhame jom shku, bar shumë sende a din, shumë sende që i kanë vjedh, se kanë jetu milictë aty a ku me ditë kush. Tanaj në 12:00 natës kajhere vike policia, "*Jel znate vi Nušu?*" [srb.: A e njihnu ju Nushën?] Ku me ditë, e kom pasë ni sërbe poshtë, ajo zar shpijunatke për mu, po unë s'kom bo kurrfarë asi delikti që me asi...

Thojsha, "*Ne, ne izvolte ličnu kartu.* Udhnoni lejen e njoftimit". {ngrit pëllëmbën e dorës} Mandej asi kurgjo... edhe të nesrit kanë ardhë, kanë vet kojshit, "Jo, Nushë nuk ka këtu, veç Lirije" a din, për mu. Edhe mu tani në punë ma boni ni sërbe, tha, "Hiç mos hi në punë, mos ja u çelë derën" a din, qishtu ma boni, ku me ditë kanë shpiunat dikush të punës. Se në punë i gjejsha letrat "*Jedan narod bez vere ne može opstati*" [srb.: Një komb pa fe nuk mund të mbijetojë] e qesi serbisht të shkruame, një popull pa fe nuk mund të jeton, nuk mund...

Edhe nifarë atmosfere e qetë shumë, ti u duhshe me punu, se deri në moment s'e kom lëshu. Tona erdh kjo nana e Arta Dobroshit, ma vonë e kom marrë vesh. Tha, "A munesh me m'i nxirre katër pacientë?" Se Merkur Dobroshi u konë ortoped, ata jane konë të Drenicës. Edhe i nxirri unë, bar 20 euro, jo 20 marka ju dhashë për Bajram, se ish Bajrami qatëherë kur fillun ato ma të mëdhatë. Edhe i nxira ata, tha, "Koke shumë" a din, "bravo të qoftë s'po u trembshe". I përcilla deri te ginekologjia, te ginekologjia i çunë, erdhën i morën do edhe tha, "I ke shpëtu" tha, "koke shumë humaniste" kjo nana e Artës. Tash s'e ngjo, veç e di kur e kom vet dikon, ajo ishte. Edhe ata fëmijë i nxira.

Mandej, dikur veç ja nisi me të madhe edhe atëherë mo nuk shkova në punë. I thashë kësaj nonës së Shpend Ahmetit, se ajo punojke te na edhe o mjeke, e pat kry mjekësinë, se e pat bo ni paузë. I thashë, "Qitëm pushim mjeksor bre se jom smutë, njëfarë gripi" nime e ftohne, kur kom shku në Gjermani. Tani dulëm të gjithë, se na morën kerrin, shkova te vllau. Te Santea e kanë pasë [shtëpinë], u kall Santea ajo pjesë. Mo, e din, ndoshta keni ndi, se jeni të reja. Ky ka qenë i vogël {tregon përballë kah nipi} dy - tre vjeç, djali.

Tani shkum dulëm aty në, e përmendëm këto, tu shku për Shkup që osht', Bllacë. Prej Bllacës tana kena qenë një vend, aty ka qenë shumë ftoht. Thashë, "E përjetova ferrin, e përjetova këtë të Rusisë, që është ftohtë shumë edhe mandej e përjetova" thashë këtë "parajsën në Gjermani". Dulën na pritën, se na shkumë në Gjermani, dikush në Amerikë, dikush andej.

Anita Susuri: Deri, deri ne cilën datë keni qenë ju në Kosovë?

Lirije Pepa: Në Kosovë kem qenë deri...

Anita Susuri: '99-tën apo...?

Lirije Pepa: '99-tën, lufta kur ka asishne, na kem shku gati në fund.

Anita Susuri: Në mars ndoshta?

Lirije Pepa: Me tren që shkojshin.

Anita Susuri: A ju ka gjet ajo në Bllacë, që u bo ai rasti, që u bllokun njerëzit?

Lirije Pepa: Kom në Bllacë, unë fotografi kom. Edhe qaty i kom.

Anita Susuri: Qysh ka qenë aty?

Lirije Pepa: Aty ka qenë, a din sikur nëpër filma, ndoshta i keni pa kështu jevrejtë qysh i kanë mundu. Ishin të lodhun mo, ni sheshir e qita {përshkruan me duar} unë kështu për shkak se mo ishim bo mos vet. Kur asishne, më ra mu najlloni, ma mur njoni prej dore e m'u thy thoni {përshkruan me duar}. A din kështu sa... qishtu i kapshe {i afron du duart tek gjoksi}. Si *Alžirska džamija* [Srb.: xhamia algjeriane] s'po di qysh kemi qenë, malltretime ka pasë. Mo në tokë flejshim edhe na kapke gjumi se të lodhun t'u mos flejt.

Rrishim edhe të veshun në shpi, për shkak se na trokitke në Sante {bën sikur troket} do sërbë, i thojshin vllaut, "Ama kerrin ose ta kalli me benzin". Tana qatëherë dul ni sërb tha, "Po ju thom si..." u konë ma kojshi i mirë, tha, "Ju përcjelli nëse doni edhe une veç s'muj kurgjo me garantu për juve" a din, se edhe ata kanë pasë nashta tortura prej tjerëve. Se në Pejë, Pejën... e kanë kall shpinë krejt në Pejë. Se a din na kishim kontakt, andej mendojshim për këta, mendojshim për këtu, krejt na ilaket në Pejë. Ky ka qenë dy-tri vjet [flet për nipin e saj], s'e di, edhe shkum. Ky u smu atje në kampin... ke Bllaca, mandej ajo tjetra, qe s'po më kujtohet emri, nejse.

E ky... ata të huajt a din krejt, NATO-s thojshin, "*No crying*" [ang.: jo me qajt], a din, se une kajsha mo, si në *Sibir*, qasi ftohti mo jemi konë mbërdhi. E ky u smu, po i vogël, villke. Tani kur hypëm në aeroplan, në Shkup na çunë, në aeroplan e drejt për në Berlin po më duket. Mandej kemi qenë, une kam qenë në Ansbah, se une kesh prej gripit edhe kom pasë sheja të mushknive aty. Tani ma murën në spital, po aty si me qenë në parajsë. A din çfarë asi bre ajo, privat klinika, po merke pare, gjoja je smutë pagun do smuje edhe dy muj e gjysë une aty në Ansbah. Këta kanë qenë në pushim në Dorn, po ka qenë... A muj, a osht' tu inçizu kjo? [i drejtohet bashkëbisedueses]

Anita Susuri: Po, po.

Lirije Pepa: Jon [i drejtohet nipit] a të kujtohet qyteti? Jo, a? I njoftun aty ku jonë bo do... S'po më kujtohet prej Berlinit ku patëm udhëtu. Veç pritje e jashtëzakonshme gjermanëve. Ju falenderona për çdo send! Pat ardhun njona meniherë, "A ki nevojë tasha?" Me pixhame patëm shku. Na prunë teshat, na prunë kalladontin, të gjitha. Mandej mu më morën në qat' spital, mu edhe disa se i mledhshin për shkak për me fitu se edhe ata e kishin fitesën. Se a din i mershin, pagujke enti për shumë smundje edhe qitshin kinse smutë a diçka. Krejt kohën ishte negativ, ishte mirë a din.

Bar unë si përkthye e ni profesoreshës që ishte se merrte gjylpona a din, dikush din, dikush s'ndin edhe këto ja përkthejsa në sërbiisht asaj. Kështu që, Gjermaninë e kemë pasë... edhe gjermankat kanë ardhë këtu me kqyrë qysh jemi rehabilitu mbas luftës. Kanë ndejt te une, dy gjermanka, ajo ka vdekë bar njona. Motra Elizabeta ka qenë e atij hajmit ku kemi ndejtun, kryesorja. Kanë ardhë, kem vizitu, kem qenë nëpër fshatra që kanë qenë në Gjermani edhe krejt, po menoj kështu ju kanë ndimur këto, a din.

Anita Susuri: Po.

Lirije Pepa: Mirëpo, mirënjohëse shumë. Mandej edhe na i përcillëm, vllavi jem shumë u kujdesë për to. Jo, diçka a din, kujtime prej Kosovës. Kështu që, kemi majt korrespondencë. Mandej me kohë, a din qysh njeri sot-nesër po habitesh, jo që po i harron, po, p'i len pak mbas dore. Kështu që, Gjermanisë i falenderona deri sa jam gjallë. Po mendoj neve na ka pshtu në ato momente edhe kanë qenë shumë... gjermanët ishin shumë punëtorë. As qekaq {tregon me gishta} nuk të jepin pa asi, po e respektojnë punën, respektojnë... pastërtia, okej krejt. A din, që thush, ni kulturë të veçantë. Ka edhe vende tjera, po aty disciplina ishte okej që thojnë.

Anita Susuri: Deshta me ju pyet edhe pak për vitet e '90-ta, ka qenë, ka qenë ni periudhë e fshtirë se jonë mbyllë shkollat, jonë mbyllë institucionet për shiptartë domethonë, jonë kriju ato paralele. Si ka qenë për juve, ju keni shku në punë e keni vazhdu, po çka kujtoni prej asaj kohës?

Lirije Pepa: Ka qenë mjerim, s'po di qysh me përshkru, se ke shku sikur me qenë krejt e izolome. Kur më ka pa ni profesoreshë e stomatologjisë... ajo ka vdekë, ni Savica, u konë e fëmijëve. Tha, "Kuku" tha, "Lirija" se a din, ajo maqedone, mirëpo... thojke, "Ku ke mrri ti, kush ke qenë" a din, "e ku mrrive tash". Jo që për vorfni, po ni vend të izolom, që thush kërkush as mos me asi... Hajt shkojsa u nënshkrujsha, krejt punojsha simbas rregullave veç për me asi, mos me të leju me të përjashtu.

E qajo ke e fundit kur të thashë për nanën e Artës kur erdh, atëherë u smuva, u smuva nifarë gripi, mos pasë qenë sarsi a çka po di une, veç me të vërtetë shumë keq jom konë, a din isha me temperaturë, me kollë, me krejt. Edhe ndërkohë ka qenë as s'fotografojshe, as s'punojsh,e veç shkojshe rrishe në zyre

deri asi, veç ndishe qishtu prej atyne pastruseve, “Jo ky kështu...” rrogën s’e kom pasë marrë kurrë, ja kom pasë fal ni pastruse, serbe u konë, thojsha mos të shkoj me më pa në dekanat.

Se me dalë me lëshu vet... se thojshin e kemi lëshu vet punën. Deri në moment të fundit, mo s’kom shku, s’di as s’kom marrë rrogë as kurgjo hiç, kjo ka qenë. Se shkollat s’punojshin, krejt privat nëpër shpia aty-këtu, a din qysh... Barem e kisha çikën e vllaut njiherë te une, e kish shkru, “Zogu mo nuk e ka atë zonin si përpara...” e s’di çka. Botimin e parë në “Bujk” barem e kom dikund atë. Ma shkrujti ja dhash ni gazetarës e përpunoi, “Qysh me ja vnu titullin?” Thashë, “Në pritje”, me të vërtetë shumë mirë, “Në pritje” a din, mo zhurma, gjithmonë po pret që ka m’u bo diçka ma mirë. Kështu që...

Anita Susuri: A ju ka ra me fotografu, për shembull këto marshet e grave, demonstratat çka kanë qenë?

Lirije Pepa: Qe çka kam fotografu unë, në Bllacë kam fotografu, marshet nuk më ka ra, se normal ka qenë situatë... Kur shkojshin këto unë isha hala në punë. E i kom fotografu helmimet, po helmimet ja kom dhonë Lule Pulës kur ka shku në Zagreb, e asaj ja ka marrë najkush. Kështu që... se filmin ja kom dhonë nji të fshatit, thashë gjuje, shkyje, prishe, se a din, më vetshin, “A ke fotografu?” “Jo”. Jo që u frigosha, po s’kisha qef a din me hi nëpër dyer tyne, jo me të marrë edhe s’vishin me më marrë. A ju ka thonë ky që ka punu me mu, nuk e di. Kërkush s’vike mu bash drejt, veç vishin okolla tjerat. A din, bar thojsha, “Mos folni palidhje” a din, “folni...” se prej drosë njeri tutët edhe mendojnë që po e marrin në burg a diçka.

Ka pasë edhe frikë. Kjo ka qenë nji farë situatë s’po di qysh me përshkru, çak edhe në banesë nuk je konë e sigurtë. Edhe unë shkoj te vllau edhe dal njiherë me nusën e vllaut, me nanën e ktyne. Delshim me ble diçka veç me kqyrë çka u bo, tek u bo, a din se, çak kajherë folshim ose turqisht ose... ajo folke turqisht ose sërbsisht, që mos me kuptu që jemi shqiptare. Po të marrin rrugës çka po din. U bo Prishtina qetësi absolute, ni atmosferë, kurgjo pandemia a din, pandemia bar tash... Po atëherë s’e ke pasë kërkond rrugës edhe ato bar shkum në pazar me ble kompira, thojke, “*Tražili ste avione, nema više kamione*”, qishtu na kanë bo, keni lypun aeroplana, qe s’ka as kamiona, demek për kësi [ushqim]...

Anita Susuri: S’ka as ushqim.

Lirije Pepa: Po. E qeto kanë qenë. Tona shkumë, nejse në Bllacë, prej Bllacës... hala s’o t’u m’u kujtu ai emri. Mandej në aeroplan për Shkup, në Gjermani, Gjermania na pshtoi, tre muj ndejtëm, si u çelë rruga na të parët kërkum m’u kthy. Kishim qef, edhe a din qysh m’u duke bre, kujtojshim që mo kurrë s’kem m’u kthy. U kthym, pritëm, dul edhe ma keq se ja nisën tanët, gjithkush i kallun, gjithkush i revoltun, kufoma, shumë kush që i ka mbytë. A din qysh m’u ka dok Peja kur kom shku... se në shpi s’ke pasë ku me flejt, po qysh të merrke dikush-dikush që ka nxonë banesë a din. Lot mo, s’po di... ndoshta prindërit e tu, e dijnë ata çfarë përjetimi ka qenë.

Prizreni nuk u konë shumë, se edhe në Prizren kam qenë me gjermanka. Kem shku me këta të NATO-s, kanë qenë gjermanët në Prizren, bar ni fotografi aty-këtu, nuk jom ku me ditë veç e kom ni fotografi në Prizren edhe xhamitë edhe këto. Edhe këto na qarosën aty gjermankat, darkën. Tana u kthyn, te une rrishin, te une se femën edhe më kanë deshtë shumë, interesant, ndoshta përshtypja jeme, më dukët që, s'di diqysh më dojshin, a ndoshta s'kom qenë farë mendjemadhe, jom konë ma kështu... jo mu përlë po ma kontaktive, a din kështu, kisha kontakte.

Anita Susuri: E qysh e keni kuptu që u kry lufta, përmes mediave apo ju ka lajmru dikush?

Lirije Pepa: Jo...

Anita Susuri: Qysh e keni prit?

Lirije Pepa: Une isha në spital aty edhe Afërdita Saraçinin, e dini, ajo ka banu me mu, ka flejt kur hini në punë '81-shin, me gjithë vllaun. Erdhën në Prishtinë, kështu që mbetën te une. Me Afërditën flejsha ni dyshek, jogin e qitshim. Edhe tash unë t'u kqyrë televizor, se kisha a din, që shënojsha {bën sikur shkruan në dorë} pi CNN e prej krejt ktyne që ka, se anglisht thojsha ta mësoj gjuhën, se i disha po jo edhe... m'u kujtojke me ni fjalë.

Kur po e shoh me Robert Kukin, me këto Kukin Afërdita Saraçini t'u folë p'i Shkupit. A dië qysh u gëzova? "Kuku", thashë, "Afërdita", a din. Mandej, Dhurata Kaba, kjo shoqe e jeme, që kemi qenë cimere, dymdhetë vjet kem pasë jetu bashkë, ajo e kish shkru ni artikull në Bota Sot. Kur po e lexoj, thojsha me pasë ditë, se unë u pata idhnu diçka me to, thojsha me pasë ditë që jemi në... qe hala s'po më kujtohet emri i qytetit aty mbas Bllacës, osht' që ka qenë edhe Bill Klintoni aty... [Stankovec]

Anita Susuri: S'po di...

Lirije Pepa: Nejse, më kujtohet dikur. Edhe thojsha, "Kish ardhë na kish marrë" a din. Kështu, veç kajsha. E kom pasë spitalin, ai ka qenë njëfarë sanatoriumi midis malit, tepër i bukur. Ni qytet sa Prishtina, Ansbah, aty kish a din, sanatoriume private. Mo deri ato, golf që lunë {lëviz dorën sikur luan} kësi, golf po, ajo loja a din, kështu. Krejt ajo private, të rregullume. Ka pasë kroatë, ka pasë gjithçka, a din prej luftës, qysh kanë marrë aty [me strehu]. Edhe aty formum shoqni, mu më dojke shumë njëfarë asi... të reja. Se aty ishin të smuta vet, po ndërkohë edhe na, ajo ma tepër si njëfarë pushimore. A din çka osht' bukuria veç nëpër filma ondërr i kom pa qato, s'di pse ondërrat shumë tregojnë gjana. Para se me shku, m'u duk sikur i kom pa dikun, a din që thojnë, sikur kjo *deja vu*, a din?

Anita Susuri: Po, po, po.

Lirije Pepa: Thojsha qysh, merre me mend në ondërr e njejta situatë më dul. Kështu që, e merrsha, ky ka qenë dy vjet, a s'di sa ke qenë? [i drejtohet nipit] Bon me durë {i ngrit dy gishta} (qesh). Tri, edhe e hypsha në krah në Gjermani {përshkruan me duar}, qershiat a din, ishin pjek kështu, thojsha merre, e i kputsha, na bike ajo gjermanka me ni kosh kështu, qershia, dredhëza, krejt këto a din. S'kom përshtypje, a din. Me profesora aty anglisht, pak edhe çdo send e shenojsha, le të më kujtohet kur të vijnë me folë. Se ma bojke, "Pepa" a din, "You eat? A po hani?" Se e kishin dertin me më shëru.

Thojsha, "Yeah, good, very good" shkojshim në restorantin me mjekë krejt. Ka qenë ni jetë super, Gjermania shumë na ka ndihmu, krejt shqiptarëve, me të vërtetë kështu kanë qenë pa hile, jo veç dallavere. Edhe Merkelken ti duhesh, duhet me asi se gati të gjithë si Merkelka kanë qenë për ne. S'kom vërejtje, mandej u kthym të parët, se morëm vesh në qershor e asi, ata s'dojshin me na lonë, se thojshin, "Qysh keni m'u rehabilitu tash atje?" Se te une merre me mend, në krejt banesën kanë ndejt policë e kanë vjedh krejt çka ki pasë të arit. Tash kush i ka vjedh nuk e di, po kishin ndejt milictë aty.

Anita Susuri: Kur jeni kthy ju?

Lirije Pepa: Jemi kthy menihere...

Anita Susuri: Në qershor?

Lirije Pepa: Mas tre mujve.

Anita Susuri: Aha, mas tre mujve.

Lirije Pepa: Mas tre mujve tamam kur dul ky NATO, e kështu a din. Qato qe i kemi pa këndeje. E kemi qenë kështu... po s'kishim mujt ma tepër me ndejt, se qaty e kom vërejtë çka domethonë vendi yt. A din që lotë shkojshin mo, merre me mend u lutsha të vdekunve. Thojsha, "Ju runi..." a din, qaq mo, veç kajsha. Tani veç nisa m'u qetësu kapak se trauma kem pasun. Kur ta kallshin qaty, Santenë aty u kall ajo krejt, secili kemi pasë trauma të luftës. Tani ajo në Bllacë, tani në atë pjesën tjetër ku shkumë, aty ftohtë në shatora, i deshëm çka kishim veç m'i mlu fëmitë se u smunë, a din prej të ftohtit. Hala s'po më kujtohet ajo...

Anita Susuri: Ju thatë që keni qenë aty kur jonë helmu studentat, çka keni pa aty? Si ka qenë?

Lirije Pepa: Aty kom pa qishtu qe, sikur që ka qenë në televizor, tanë t'u nga tu i pru nëpër klinika. Ni profesor thojke, kur dikush helmohet te tonë tjerët e marrin helmimin se ajo ndikon. Edhe mu më nxuni ni profesor i internos, ai ka qenë reumatolog, ma murr aparatin {bën sikur kap diçka}. Tha, "A ke fotografu?" Ai më dojke shumë se kom punu punë për to a din, thojsha, "S'kom fotografu" a din. "Sigurt?" Une, "Sigurt". Thojsha, me marrë filmin me nxirrë, priset, punë e madhe, a din. Ai kurgjo, s'e çeli aparatin.

Tha, “*Lutko moja*” [srb.: Kukulla ime] a din. Tha, “Këtu nuk e dijnë çka o SUP-i” a din. Demek me të çu atje... veç trego a din, unë, “Jo, s’kom fotografu”. Edhe mandej i bona fotografitë, ja dhashë Lulës, ajo shkoi në Zagreb. Shkunë ata, kanë pasë njëfarë, jo kongresi po në lidhje me këto... Ja merr dikush fotografitë. Kështu që, mbesim pa... mbeta edhe une, se filmin ja pata dhonë një të fshatit, kanë qenë do laborantë. Thojsha, “Asgjaso”, a din që mos të na qesin telashe a diçka, “Ki fotografu, s’ki fotografu”. Qishtu. E helmimet kanë ardhë me të mëdha edhe u ndike era e njëfarë kimikalje. Kështu, edhe sytë na djegshin, s’di pse...

Anita Susuri: Ju keni qenë nëpër klinika ku ka ndodh?

Lirije Pepa: Jo, në klinikë, po kam qenë në oborr, se në oborr a din, aty i fotografojsa edhe në klinikë në disa vende, {numëron në gishta} në transfuzion... në do vende aty kajshin, piskatshin, tash s’besoj që kanë aktru në qat’ mënyrë, s’ma merr mendja. Mu më duket që ka qenë reale, ka pasë shumë të helmum, tash a e kanë qit me qëllim a pa qëllim, çka kanë bo aty, e din ata që janë marrë me kësi sende. Kjo ka qenë e tëra. Mandej në punë kom shku mbas, më kanë thirrë, Mazllum Belegu si dekan.

Anita Susuri: Pas luftës?

Lirije Pepa: Pas luftës kjo. Edhe po më thirrë një bibliotekiste, punojke Shukranja, tha, “Lirije hajde po të thirr prof...” a din kështu, “ndaqe në punë”. Edhe une u paraqita meniherë. Thashë, pse me më hup, a din, meniherë në punë. Bar ky i Francës qysh e pat emrin, ky u konë i madh si ministër tash? [Kouchner]¹⁷. Kuku bre, çka p’i harroj shpejt do emra...

Anita Susuri: S’o me rendësi.

Lirije Pepa: Nejse, ai po ma bon edhe ai qishtu qe, “A je mjeke?” Thashë, “Jo, jo, fotografe” (qesh). Se ai vike me kqyrë a po na jepin ato ndihma, a din, se u bo njëfarë fondi, a din që dojshin me na regjistru për me marrë rroga, une e kisha atë bexhin {prekë krahrorin} fotografe, a din me to që delsha.

[Këtu ndërpritet intervista]

Lirije Pepa: Bernard Kushneri ishte ai që... ka qenë atëherë për Kosovën, jo na ndihmojke, jo vike në çdo institucion, qysh jemi, a din, kush çka punon, tek punon edhe mandej ka shku ma mbarë. Na jepshin ka... atëherë ka qenë marka ende, ka njëqind marka, a s’di valla. E në Gjermani na kanë dhonë ka 80 marka në mujt, plus ushqimin, krejt i ke pasë gratis, na kanë ndihmu.

Anita Susuri: Pas pensionimit me çka jeni marrë, a keni pasë naj aktivitet?

¹⁷ Bernard Kouchner (1939) ishte politikan dhe mjek francez, i cili ishte perfaqësuesi dytë i dërguar në Kosovë nga ana e Kombeve të Bashkuara dhe shef i misionit të UNMIK-ut.

Lirije Pepa: Mas pensionimit nuk jom marrë me kurgjo. Njiherë deshta si humaniste, me ni shoqe, a din në kishë, mos ka nevoj, jo me pare veç sa me punu diçka, po s'ish asi edhe mandej s'jom marrë me kurgjo. Po mendoj qishtu qe, pata shku në Shqipëri. Hera e parë ka qenë, shkumë menjëherë mbas luftës. Ka qenë organizatë kështu Arjeta Kelmendi po më duket, organizim, po mendoj m'u marrë me veprimtari të ndryshme, kush don me çelë, po ajo nja 15 ditë njifarë si seminari, si... s'po di me përshkru. Aty shkojshim në ligjerata, na mbajshin profesorat e Shqipërisë. Kishe edhe ekonomi, kishe edhe kështu...

Bar njiherë ni pyetje ju bona, “Çmimi Nobel, a osht' fitimprurës?” A din, se i msojshim për me organizu kur don diçkafin, qysh. Qaty ram dakord me do profesora, ishin do profesorë, do ishin asi, për shkak që e tregojshin ngjarjen gjatë Enver Hoxhës. Kajherë s'na interesojke, jo për diçka po mos të bijmë në pozitë, m'i pyt s'i pytshim, po ato vetvetiu. Se fitun edhe ato tash... se thojke njona, “E kom lexu edhe Kur'anin edhe Biblën edhe krejt këto” a din, ajo fenë me të vërtetë, unë i respektoj të gjitha fetë {vendos dorën mbi gjoks}, të kujtdo, për veti besoj, diçka ekziston për mu, a din s'osht' e thonme. Mirëpo, për shembull m'u mpshtillë nuk isha mpshtillë kurrë. Jo une po edhe ajo, a din që u mpshtillshin disa për përfitime.

Kem pasë studente të mjekësisë kurgjo hiç u mpshtillshin, e knej u përqafshin, a din. Po du me thon, nëse e don fenë, feja osht' krejt diçka tjetër. Une e respektoj fenë e çdokujt, mirëpo besoj, edhe lutjet i knoj për shkak... si njeri, a din qysh {bashkon dy duart} i ki do sende që ndikojnë pozitivisht. Sikur dikush që bon joga a diçka për m'u qetësu edhe mu ato më kanë mbetë edhe mandej Zotit i drejtona që me m'i çelë rrugët mbarë. Gjithkush e ka ato në mënyrë të vetën.

Mirëpo, s'kom qef me ndiku te kërkush, po m'i respektu po, gjithkush për veti e ka. Këto kanë qenë të tërat po mendoj kështu. Pas pensionit, pas asaj s'jom marrë me veprimtari kurrëfare. Mirëpo, kështu jo kom lexu, me shoqni, kemi shoqni qe 50 vjet sikur studente kur kemi qenë, na ende, tash veç një shoqe na ka vdekë edhe mu më ka pasë vdekë një shoqe prej kancerit. E kështu jemi dhetë veta që vazhdimisht ndjekemi, po s'jemi pa qe tre muj. Veç i çoj fotografi për shembull...

Anita Susuri: Për shkak të pandemisë, a po?

Lirije Pepa: Ju çoj fotografi që isha këtu ose isha këtu.

Anita Susuri: Për shkak të pandemisë, a po?

Lirije Pepa: Pandemisë, po.

Anita Susuri: Deshta me ju pyt tash edhe... se u afrum ka fundi, pak te këto vitet e fundit. Sivjet domethonë është pandemia edhe ka qenë karantina, si e keni kalu ju këtë periudhë? Qysh ka fillu për juve?

Lirije Pepa: Me tregu të drejtë, unë nashta pak tip, gjithmonë e kom pëlqy pak vetminë, a din se vet unë kom jetu. Edhe nejse me shoqni na dalim në kohë të caktume kur asi... Po krejt kohën kom lexu, mandej kqyri filma, serialet i kom do që më pëlqejnë, i përcjelli dokumentarë të ndryshme. Mandej situata politike tash s'du me ndërhy, unë pak a shumë i takoj VV-së a din (qesh). Më pëlqen tash nuk osht' e thonme me përmend, ajo osht'...

Anita Susuri: Zgjedhja juj osht', keni t'drejtë...

Lirije Pepa: Kështu që, debate të ndryshme kajherë u bojsha nervoz, kajherë jo. Kajherë dilsha në ballkon kqyrsha, a din, pak a shumë... se une e kom pasë vetminë, mirëpo kur dojshe me shku dikun ti po duhesh maskën {afro duart te goja}, po duhesh me kqyrë a je tu asi... Mu më ndihmoi shumë vllau edhe fëmitë e vllaut. Ata kanë qenë permanent, po mendoj kur m'u ka duftë diçka me më ble barna ose diçka, se une, kom hipertension e kom do sende që, normal a din me moshë, e m'i blejnë këta krejt. A din, kështu që, prej tyne faleminderes s'kom pasë problem edhe gjithmonë jonë diqysh...

Unë edhe vllazën tjerë, në Pejë, e në Belgjikë, po me këta këtu jom rritë, në dorë teme a din kështu, kështu që jemi konë shumë të lidhun. Edhe nuk ma kanë hup, qe këtë m'i thonë në gjysë nate, "Ron..." ose çikës motrës ose vllaut, shumë faleminderes prej tyne a din, se njeri s'din a ka kohë. Sot je, nesër s'je, a din, mosha. Mandej, pak e kom marrë... m'u frigu s'jom frigu, mirëpo panik s'kom pasë, e kom pasë ato për shkak mos kom unë diçka muj me ja ngjitë. Edhe sa na lindi nusja vllaut, a din, e atë bebë shumë po e dojmë a din, diqysh frigona me prekë, frigona...

Kështu boll dezinfektona {prekë duart} si të shkoj i qes mindilat nëpër brava, nëpër asi. Mirëpo, s'besoj që diçka se ato simptomet i kom kalu une me një grip të përparshëm, qeto qysh përshkruhen. U pata smu para tri-katër vjetëve, ama krejt njajtë m'u kanë dukë. Qysh po i përshkruan, s'kom pasë as apetit, as kurgjo. Tash mirë jom, s'muj me thonë temperaturë ose kollë kurr s'kom. Edhe pse me bo testin s'e boj. Jo për diçka po, jo që s'kom besim, se do sende po jonë s'pi din njeri.

Anita Susuri: Zonja Liri, edhe për fund nëse kishit dashtë diçka hala me shtu ose nëse ju ka mbetë diçka që doni me thonë, lirisht thujeni, na tregoni.

Lirije Pepa: S'di çka kisha me thonë, ju dëshiroj shnet të gjithëve, kjo pandemi m'u largu sa ma parë (qesh). Kështu që, me qenë pak a shumë ma të lirë, se me të vërtetë, po më dhimet rinia, për shembull ju. Tash në kohën e juj, unë ndoshta kam qenë në vendin, pozitën ma të mirë, e kur ju shoh mshelë nëpër shpia, tash s'muj me krahasu kohën teme, me kohën e juj, une 75 vjeçe, ju tonë të ri. Po çka me bo, qajo më dhimet.

Se une e di që kom me vdekë edhe njiqind vjet me rruu prapë kom me vdekë. Kështu që i lutna Zotit veç me kollajllëk, ama të rive veç me ju çelë, me fillu jeta normale, se vet shumë fshtirë. Hajt une lexoj po edhe leximi kajherë s'po të tërheq se po je kureshtare me ditun, në televizor, çka po bohet, e ku po bohet, a na erdh Grenelli, a s'na erdh (qesh). A ka ardhë sot? [i drejtohet bashkëbisedueses] Ju si gazetarë... po boj hajgare, pak ashtu na ka mbetë se prej... që thush ma tepër pi nervozës, po e shprehi ndryshe.

Veç shumë fshtirë edhe për fëmijë. Çfarë shkolle osht' ajo kur nuk e përjeton ti bankën, shokët e klasës, ato ngucjet që bohen nëpër klasa. Çfarë shkolle kjo ti me anë të asi {shikon pëllëmbën e dorës} kur, unë 75 edhe shpesh i thirri kur më prishet najsen, thom, "S'po di me lëshu, s'po di kështu" a din teknikën s'e njofim, po mendoj mosha jeme se ju të ritë bar aty... Veç edhe kritikë për të ritë tanë kohën janë me telefona, po s'ki çka aty i merrni krejt, jo kjo kështu, jo... (qesh) Kjo ishte e tëra faleminderës për ju!

Anita Susuri: Falemnderit shumë edhe prej juve!

Lirije Pepa: Pak nashta ja kom tepru po...

Anita Susuri: Jo, jo, jo...

Lirije Pepa: Se penzionerat edhe plakat e kanë guhën e gjatë (qesh).

Anita Susuri: Tamam puna. Falemnderit!